

BASHKIM KUÇUKU  
**UNI KRIJUES DHE VEPRA**  
INTERVISTA

---

BOTIMET TOENA



BASHKIM KUÇUKU

# UNI KRIJUES DHE VEPRA

Intervista me shkrimtarë, gjuhëtarë, përkthyes  
(1979-2017)

BOTIMET TOENA  
Tiranë, 2019

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo  
Korrektore letrare: Petrina Ago  
Përkujdesja grafike: Elida Stafa  
Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-48-0

© Autori dhe *Botimet Toena*

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**  
Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë  
Tel.: + 355 4 22 40 116  
Email: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)  
[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)  
[www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)





## INTERVISTA - MËNYRË KOMUNIKIMI AFËRSIE

Intervista është një mënyrë komunikimi bashkëkohore universale, nëpërmjet së cilës sqarohen drejtpërdrejt para të interesuarve probleme të caktuara. Të lexuarit dhe të parët me sy, të dëgjuarit me veshë të të intervistuarit, me anë të mediave, krahas popullarizimit, krijojnë intimitësi dhe rritin përgjegjësinë e tij për ato që thotë, sepse, pas kësaj, do të jetë i ballafaquar me publikun. Shkrimtarët dhe artistët, të mbështjellë me një tis magjie, si pasojë qoftë e ndikimit të madh të veprave të tyre, qoftë e fantazisë subjektive të adhuruesve, me anë të bisedës bëhen “tokësorë”, të afërt, më të kuptueshëm, dhe, gjithsesi, më të mundshëm për t’u familjarizuar, prekur, pse jo edhe për t’u barazuar me ta.

Po intervistuesi, kush do të duhet të jetë? Cili është roli, ndihmesa e tij?

Ai, në radhë të parë, do të duhet të jetë specialist i fushës, njohës i veprës dhe i jetës së shkrimtarit a të artistit për t’i zbuluar me pyetje thellësitë e vetëdijes, karakterit, laboratorit krijues, dhe, më kryesorja, sa më afër në shkallaren kulturore me të, për ta detyruar të përgjigjet për fshehtësi thelbësore, madje, edhe për ato, për të cilat nuk ka dëshirë të shprehet. Në bashkëbisedime të tilla, ka rast të marrë në dorë nga vetë krijuesi disa “çelësa” të sigurt të interpretimit të veprave, duke luajtur rolin e lakmuar të ndërmjetësuesit midis shkrimtarit e artistit me publikun. Në një tryezë me të, mund ta pohojë personalitetin e vet, kur e përballon denjësisht, dhe, po ashtu, mund të zbehet, të ulet e të diskreditohet, nëse, është larg e poshtë kulturës së tij. Në sistemin me censurë, intervistat ishin mjaft të kufizuara. Ato i jepnin drejtuesit e institucioneve, në përvjetorë të çlirimit, të themelimit të partisë, në fushata zgjedhore, konkurse letrare e artistike, me emra të miratuar nga drejtoria përkatëse e shtypit dhe e propagandës. Redaksia, aq më pak gazetari, nuk kishin të drejtën e iniciativës pa lejen e saj. Shkrimtarëve dhe artistëve, të cilët adhuroheshin mbi autoritetin e partiakëve dhe zyrtarëve, nga frika e popullarizimit, u merreshin rrallë. Ndikimi i tyre ishte i jashtëzakonshëm, sepse, duke i veçuar prej tërësisë së madhe të uniformizuar nga barazitizmi formal, i ngrinin në pedestal.

Kur ëndërroja të punoja te revista letrare *Nëntori*, meqë diskutohej emri im, dhe, pas tre vjetësh, u njoftova, se do të punoja redaktor i kritikës letrare te gazeta *Drita*, mars 1974, përfytyroja kënaqësi të veçantë në takimet, bisedat, intervistat, miqësitë me shkrimtarë, “nevojën” që do të kishin për mua, për t’i nxjerrë në faqet e saj. Mirëpo, kënaqësia e intervistave nuk m’u dha. Si redaktor i kritikës letrare, që lexoja veprat një për një dhe i përcillja me shkrime të bashkëpunëtorëve, që ndiqja veprimtaritë e Lidhjes së Shkrimtarëve, më takonte edhe rubrika e intervistave, të cilën ia kishin dhuruar redaktorit të traditës letrare, muzikore, historike, një lloj gazetari populist.

Ndonjëherë, që pata guximin të shprehja dëshirën për ta mbuluar unë atë rubrikë, përgjigjja e kryeredaktorit ishte:

- Ti ke kritikën letrare, boshtin e gazetës, të duhet që gjithë kohën të përqendrohesh tek ajo.

Moslejimi im, tanimë, pa paramendim, vazhdoi edhe me kryeredaktorët e tjerë, Xhevat Lloshi dhe Zija Çela, miqtë e mi, studiues e shkrimtarë me kulturë.

Për ta konkretizuar, sadopak, këtë dëshirë, pjesë e punës studimore, gjeta një dritare. I kërkova (1984) Dritëro Agollit të zhvillonim një bisedë intime dhe profesionale për krijimin dhe botimin e njërit prej romaneve më origjinalë të të tëra atyre viteve *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*, edhe me arsyetimin, se po i afrohej pesëmbëdhjetëvjetorit të qarkullit në duar të lexuesve. Me modestinë e vet popullore, ai pranoi menjëherë.

## NJË INTERVISTË, GATI, E PAMUNDUR

Rregullin, pa e ditur, e theu shkrimtari Agim Cerga, duke më detyruar t’i marr intervistë atij, që nuk do të më shkonte mendja kurrë, pale të guxoja, profesor Eqrem Çabejt, për të cilën janë shkruar këto radhë, si dhe për fisnikërinë e pazëshme të profesor Mahir Domit.

Ka qenë gusht. Më kujtohen lëvizjet nëpër vapë për të gjetur lëndën e numrit vijues.

Agim Cerga, atëherë sekretar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve për letërsinë, ishte ngarkuar të drejtonte përkohësisht gazetën *Drita*, pasi kryeredaktori Duro Mustafaj, përpunuesi më i dalluar i imitimit të “Revolucionit Kulturor Kinez” në trajtimin e letërsisë, ishte shkarkuar për një sërë paudhësish, ndër të tjera edhe për nxitje konfliktesh në kryesinë e shkrimtarëve dhe në redaksinë e gazetës.



Në diskutimin e zakonshëm për përmirësimin e cilësisë së gazetës, befas iu shkrep për intervista.

- Përse nuk merrni (nuk e quante veten pjesëtar të redaksisë, por ndihmues të saj) intervista nga shkrimtarë dhe artistë, studiues, historianë, gjuhëtarë? Ato e bëjnë të lexueshme gazetën. Ti (m'u drejtua mua), pse nuk merr intervista?

- Unë s'kam marrë ndonjëherë, - iu përgjigja.

- Do të marrësh tani. Do ta fillosh me Eqrem Çabejin. I keni marrë atij?

- Me gjithë mend e keni apo e keni me shaka? - ia ktheva. - Ai s'do t'ia dijë nëse ka gazetë *Drita*, apo, nuk ka. Bëhen, apo nuk bëhen intervista.

- E gjetët vërtet, kujt t'i merret, - ironizuan të tjerët.

- Ti, derisa t'i marrësh intervistën nuk ke asnjë detyrim tjetër. Si e qysh do t'ia bësh, është puna jote, - e preu shkurt.

- E vetmja mundësi nga mund ta kapim është vepra e tij *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, që ka filluar ta botojë Akademia e Shkencave.

- Ja, që u gjet mundësia.

Fillova ta vrisja mendjen, duke qenë i bindur se ishte e pamundur. Brezi ynë nuk pati fatin të dëgjonte ligjëratat e tij. Dy-tre vjet para nesh nuk dha më mësim në universitet. Duke qenë student, kam ndjekur një ligjëratë të tij tepër mbresëlënëse për etimologjinë e shqipes para profesorëve të fushave të ndryshme, në sallën e Rektoratit të Universitetit.

Në redaksi nuk e kisha parë të vinte. Edhe në ndërtesën e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve, ku ishte edhe redaksia, e shihje në raste të veçanta, kur ishte i detyruar të vinte për respekt të problemit, ose, të jubilarit. Një shkrim, që kishte botuar te *Drita* me titullin *Një njëqindvjetor*, kushtuar, në mos gabofsha, albanologut Norbert Joklit, e kishte sjellë sekretarja e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Meqë më ishte ngarkuar mua ta lexoja dhe ta përcillja te kryeredaktori, lënda në daktiloshkrim pa asnjë gabim teknik, fletët të lidhura, mbështjellë në zarf, me adresën e gazetës *Drita*, duke m'u kujtuar më trembin edhe më, sepse kishin krijuar tek unë përfytyrimin e një përkore të madhe.

- Sidoqoftë, - thashë, - të bëj timen! E para, të marr vesh, se ç'natyrë ka profesori. Nga larg e me të dëgjuar e dinim, se ishte tërësisht i përqendruar te puna e vet shkencore, në Tiranë, e gjetiu lëvizte pak, miqtë e shokët i kishte të përzgjedhur, edhe për arsye të moshës, por edhe sipas kodit etik të dikurshëm. Për të ditur konkretisht dhe nga burime të sigurta për natyrën e tij, bisedova me studiuesin Jorgo Bullo, shef i sektorit të studimeve letrare në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, që punonte në të njëjtën ndërtesë me profesorin.

- Pak e çuditshme, kjo kërkesë, - më tha Jorgoja. - Eqrem Çabej, gazeta dhe intervista janë të kundërt me njëri-tjetrin. Megjithatë, ti provoje. Po t'u përgjigj, do të jetë një gjë e rrallë. Bisedoje me Seit Mansakun, atë ka ndihmësin kryesor. Po e mori ai përsipër, edhe mundet.

Seiti nuk e mori përsipër.

- Profesori është natyrë e vështirë për një punë të tillë. Nuk i them dot.

Më mbeti të përballësja vetë. Duke e ditur se kishte drojën e zyrave qeveritare, më erdhi një ide. Do t'i them e kemi porosi nga lart, që nënkuptonte Komitetin Qendror të Partisë, përkatësisht Drejtorinë e Shtypit e të Propagandës. Me këtë pranonte të përgjigjej kushdo, sado "i vështirë" të ishte.

Me të vetmin çelës, dhe frikë se mos më nxirrte edhe jashtë, trokita. Zyra ishte shumë e vogël, ngjitur me zyrën e drejtorit, Androkli Kostallari. Ulur si i ngucur, në një tryezë edhe ajo shumë e vogël, dhe vetë profesori i imët, më pa habitshëm, sesi hyri një i panjohur, që nuk ishte punonjës i institutit. Pas përshëndetjes dhe të falurit të tepruar, që po i kërkoja për shqetësimin, ndiqte me shpërfillje fjalët e mia: gazeta, kërkesat e lexuesit, dëshira e redaksisë, porosia e kryeredaktorit etj. Kur zura në gojë intervistën, nuk di, ndofta, i jam dukur "i lajthitur".

- Ç'lidhje kanë këto me mua? - ma preu.

M'u desh t'ia përsërisja ato shkurtimisht, të cilat mezi filloi t'i dëgjonte.

- Unë s'jam për intervista. S'kam dhënë ndonjëherë. Shkoni te ndonjë koleg. Mos më shqetësoni.

Që, e kthyer në shqip, do të thoshte, tani shko, në mos, mbathja.

Në pikën më kritike u tregova këmbëngulës.

- Ju kërkoj, vërtet, ndjesë, por më kuptoni përse ngul këmbë. Vij me porosi të kryeredaktorit. Kryesia e Lidhjes së Shkrimtarëve ka kritikuar redaksinë "Pse nuk ju ka marrë juve intervistë, sidomos tani që ka dalë vepra madhore *Studime etimologjike në fushë të shqipes*?". Ky është quajtur faj i redaksisë.

- Kryesia e Lidhjes ka punët e veta, - ma ktheu.

- Më vjen keq që jam i detyruar t'ua shpjegoj, pasi nuk jam i autorizuar. Kritika ka ardhur nga lart, "Pse e mënjanoni profesorin?". Prandaj, ju shqetësoj. Ndryshe nuk do të guxoja t'ju trokisja në derë.

- Mendon, se është kaq e ngatërruar, një gjë e thjeshtë?

- Nuk di më tej. Pa këtë barrë nuk do vija.

- Kam punët e mia. Nuk shkëputem dot... Më duhet ta mendoj.

Dhe, pas pak.

- Si bëhet kjo punë?

Nga “thyerja” e tij, mora kurajë. Fjalët më vinin me vrull, por i pengojta... Fola sa më shkurt, se mos mërzitej dhe ndërrota mendim.

- Është fare e thjeshtë, profesor. Me mundësitë e mia modeste, meqë kam mbaruar për gjuhë shqipe dhe letërsi, do të përpiqem të formuloj disa pyetje.

- T’i shikoj pyetjet, pa u jap përgjigje.

Me mirësjellje të përunjur, nuk dija si ta falënderoja.

Përsëri te Seiti, i cili u habit nga përgjigjja e tij.

- Kam frikë se do ta kthejë fjalën. Mos e ka bërë për të më hequr qafe?

- Jo. Po të ka thënë kështu, do të përgjigjet. Fjalën nuk e shkel kurrë.

- Tani është radha jote, të më ndihmosh për pyetjet.

- A, jo, është e pamundur. Po ta marrë vesh që unë do t’i bëj pyetjet, unë nuk punoj dot më me të. Ai është i prerë. Këtë e quan pabesi dhe nuk ia fal askujt.

- Si të veprojt?

- Vetëm profesor Mahiri mund të të ndihmojë, nëse pranon. Atë e ka mikun më të ngushtë. Ia njeh natyrën. Po e pati guximin?!...

Me profesor Mahirin ishte më e lehtë. Më dëgjoi me vëmendje. Edhe atij i pëlqente që gjuhëtari më i njohur, i mbyllur në punën e vet, të komunikonte, qoftë edhe një herë, drejtpërdrejt me lexuesin.

- Po më vë në vështirësi! Mirë është të japë një intervistë, edhe për gjuhësinë, edhe për atë vetë, edhe për lexuesin. Këtu nuk bisedojmë dot, sepse, po e mori vesh, nuk di si t’i përgjigjem. Mik e kam, po ai ka rregullat e tij, të cilat unë ia respektoj gjithmonë. Do të lëmë një takim. Në zyrë, ju lutem, mos të vini më, sepse mund t’ju shikojë, ose, ta marrë vesh.

I mirësjellshëm, i gatshëm për të ndihmuar dhe i përpiktë, me profesor Mahirin u takuam te *Kafe-Pastiçeria* e Pallatit të Kulturës, ndër më të mirat e asaj kohe, në katin e tretë.

- E para e punës, - më tha, - nuk e di në jeni i besës. Do të ma jepni fjalën, se nuk do ta marrë vesh njeri, që pyetjet do t’i bëjmë bashkë.

Pasi e sigurova për këtë, më këshilloi t’i formuloja idetë e mia, se çfarë kërkoja, për t’i mbushur me lëndën përkatëse dhe t’i përpunonte shkencërisht. Me gjithë ngurrimin tim, të cilin ia shpreha, se mos shkruaja vulgaritete, i formulova. Në takimin tjetër, në të njëjtin vend, profesori i solli pyetjet në daktiloshkrim. Më rikujtoi besën, që duhet ta mbaja dhe mos ta shkelja në zyrën e tij.

Afër mesditës, në zyrën e ngucur, ia dhashë pyetjet. Ai i ulur, unë në këmbë, sepse nuk kishte karrige tjetër. Meqë isha në këmbë, e vëreja në mimikë pa më kuptuar. Nga leximi shpërfillës, sikur kaloi në një lloj

habie dhe dyshimi të pavetëdijshëm, nëse i kisha formuluar unë. Leximi mbaroi vëmendshëm. Më vërejti me mosbesim në thellësi, të pangritur në sipërfaqe.

- Mirë, do të mendohem.

- Ju lutem, kur mund t'ju shqetësoj në telefon?

- Këtu, mos më shqetësoni më. Më keni humbur shumë kohë. Më keni prishur punë.

- Mund t'ju marr në shtëpi? Mjafton të më thoni, në cilën orë, nuk ju shqetësoj.

Më caktoi rreth orës 17:00, pasi binte zhegu, ose, çohet nga pushimi i drekës.

Pritja në telefon, edhe pse i thashë me tërë mirësjellje se kush isha, qe befasuese:

- Ju lutem, kush jeni ju që më shqetësoni? Kush ju jep të drejtë të telefononi dhe të kërkon llogari?!...

Mendova, se do ta kishte harruar edhe bisedën, edhe atë që kishte marrë përsipër. U tërhoqa qetësisht, duke i sqaruar:

- Më keni dhënë leje t'ju telefonoj, në ditën dhe në orën, që ju mora.

Vazhdoi në të tijën, që nuk kisha të drejtë ta shqetësoja.

Mbeta në pritje. Një ditë qëlluam ballë për ballë te *Pallati i Kulturës*, te hyrja e sotme për në *Bibliotekën Kombëtare*. Edhe ai u drejtua nga unë. Më i përmbajtur, ndonëse, me një lloj mllefi ndaj “padrejtësisë” që i kisha bërë, më shpjegoi se kishte të drejtë. U zura ngushtë. Nuk dija si t'ia ktheja. Nuk doja as ta lëndoja, as ta kundërshtoja.

- Ju kërkoj ndjesë, që ju kam shqetësuar! Ndoshta, nuk ishte ora e përshtatshme. Mund të më lini një orë tjetër.

- Si guxoni ju, të telefononi në shtëpi?

- Më falni, profesor, por më keni dhënë ju leje, t'ju telefonoj. Ndryshe, si mund t'ju merrja?

- Është e vërtetë që ju kam dhënë leje?

- Po, më keni dhënë edhe numrin e telefonit.

Mbeti.

- Në është kështu, ju kërkoj ndjesë.

- S'ka gjë. Unë ju kërkoj ndjesë!

U takuam dy herë te një kafë e vogël, e pastër, ngjitur dhe para se të hyje te restorant *Peshku*, në krye të rrugës *Abdi Toptani*, aty ku takohet me rrugën që vjen nga Sahati dhe vazhdon për në *Rrugën e Elbasanit*, më tej kullës së sotme, e ngjashme me një piramidë kokëposhtë. Në atë kafë kthehej me ndonjë mik, sepse, sikurse më sqaroi, “bënin kafë të mirë, ishte

qetë, dhe nuk humbje kohë, se ishte në këmbë”. Në të dyja takimet patëm biseda të lira për punët studimore letrare, universitetin, gazetën letrare, për të cilat ishte i interesuar të dinte diçka.

Në bisedën e zakonshme, nga je, për çfarë i ke kryer studimet etj., vendlindja Konispol dhe mbiemri im i tërhoqën vëmendjen:

- Familja, fisi juaj, ka lidhje me Muhamet Çamin?

Kur dëgjoi se isha nga ai fis, pyeti:

- Më vjen mirë. Po ç’studime ke bërë për veprën e Muhamet Çamit?

- Nuk kam bërë, - iu përgjigja, duke ngritur supet.

Muhamet Çami dhe vepra e tij, pas luftës së madhe kundër fesë dhe institucioneve fetare, ishte hequr nga *Antologjitë* dhe tekstet shkollore. Diku, me disa rreshta kritikohej se ishte përfaqësuesi tipik i përhapjes së besimit islam. Për mua nuk ishte vetëm kjo arsyeja përse nuk kisha punuar me të. Më tërhiqte fort letërsia bashkëkohore, njohjet, debatet me shkrimtarë dhe kritikë, ndonëse debate nuk kishte. Ato i kishte mbuluar miqësia e “mirëkuptimi” me të gjithë, bisedat e kafeneve dhe shkrimet e censuruara.

- Po punimin e diplomës, nuk e keni bërë për veprën e tij?

- Jo.

- Kjo është keq për ty! Si ka mundësi mos të interesohesh për veprën e tij, që është në çamërisht, një nga vlerat e mëdha të gjuhës shqipe?! Ti, do të ishe i pari që do të interesohesh.

Qortimi këmbëngulës më vuri në pozitë për të arsyetuar në ndonjë mënyrë, që deri atëherë nuk më kishte shkuar ndër mend.

- Është e vështirë, profesor. Të them të drejtën është jashtë mundësive të mia.

- Pse?

- Më duhet medoemos të njoh, apo të kem të dhëna për letërsinë arabe.

- Të lexosh.

- Që të lexoj, më duhet të di arabisht.

- Do ta mësosh. Do t’i hysh dhe do ta mësosh.

Foli sikur mësimi i arabishtes të ishte fare i thjeshtë dhe do kryhej për një kohë të shkurtër.

- Arabishtja, larg shqipes, është e vështirë.

- Nuk ka gjuhë të vështirë. Edhe arabishtja është një gjuhë si të tjerat. Sa studiues e mësojnë në botë!

- Më duket, se nuk shkon. Unë një pasardhës të shkruaj për paraardhësin tim. Ngjan se dua të ngre veten.

- Kjo, nuk shkon. Unë të them studioje, jo lavdëroje. Ti je studiues.

- Të paktën, kështu, kam menduar.

- Të të shpjegoj, pse e ke gabim. Çdo njeri punën e fillon nga prejardhja e tij. E njeh prejardhjen e tij, njeh dhe të tjerët me të. Pastaj vazhdon me shkrimtarë të tjerë. Po ta them si mik, sepse e kam bindjen të tillë. Çdo njeri, që nuk niset nga e tija, nga ajo që njeh dhe e ka për detyrë, nuk mund t'i shkojnë punët mirë. Edhe ty nuk kanë për të shkuar punët mirë, derisa ta kryesh këtë detyrimin. Mos të të vijë keq dhe mbaje mend!

Më vonë kam menduar, dhe sot e them: "Mos ka dashur me këmbënguljen e tij të më bindte të studioja një traditë, që nënvleftësohej dhe hidhej poshtë, dhe, që, brezi i ri po largohej prej saj?"

Këtë refren nuk harronte të ma kujtonte, madje dhe me një lloj ironie, në të tria herët që u takuam në kafë, dhe, kur shiheshim diku rastësisht.

- Gëzohem, profesor, që ju shikoj. Punët, besoj, ju shkojnë mirë.

- Mua mirë më shkojnë. Po ti nuk i ke mirë. Kur të më thuash që ke filluar studimin për Muhamet Çamin, atëherë do të shkojnë mirë.

Intervistën e mora në zyrën e vogël të Institutit. Pata përshtypjen se shpëtoi nga një barrë e madhe. Megjithatë, duhej dhe fotografia.

- Më falni, profesor, edhe një bezdi të fundit.

Më pa me vëmendje.

- Është e domosdoshme një fotografi!

- Fotografi nuk kam.

- S'ka gjë. Vjen fotografi i gazetës në zyrën tuaj.

- E kam të vështirë fotografinë. E lëmë me kaq, - tha si me lutje.

- S'kam ç'bëj, është rregull. Intervista shoqërohet me fotografinë e të intervistuarit. Vetëm thoni ditën dhe orën, që e keni për mbarë.

Fotografi i gazetës, Fatos Maliqi, i bëri disa foto. Njërën, më të njohurën, e kam parë të botuar në faqet e shtypit të asaj kohe. Vite më vonë m'u desh një foto e tij për revistën *Universi Shqiptar i Librit* (1997/3), për të shoqëruar shkrimin e prof. Seit Mansakut për *Studime etimologjike në fushë të shqipës* IV. Kërkova në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, te punonjësi i Arkivit. Ai më dha një prej atyre fotove, e cila nuk ishte dhe aq e qëlluar, prandaj, i thashë të më jepte një tjetër.

- Më tregoi katër-pesë. Ishin të atij momenti. Të tjera s'kemi, - më sqaroi.

Më erdhi keq. Një institut shtetëror, të mos kishte një dosje sosh për gjuhëtarin më të madh, ishte edhe e pabesueshme, edhe revoltuese. Meqenëse nuk kishte të tjera, në shenjë ndëshkimi, nuk e ktheva as atë.

Takimin për t'i dhënë disa kopje të gazetës me intervistën e botuar, e la te kafja e hotel *Dajtit*, e paracaktuar për të huajt, shoqëruesit shqiptarë,

sigurimsat dhe disa personalitete të rralla të letërsisë e shkencave, prej të cilëve nuk mund të përjashtohet Eqrem Çabeji. Mbaj mend se kisha hyrë nja dy herë për të takuar shkrimtarin Shefqet Musaraji, i cili aty pinte kafënë dhe shkruante. Nën hijen e tij nuk ngjallja dyshim.

Erdhi me përpikëri minutash, me xhaketën verore që e mbante gjithmonë, veshur ose hedhur krahëve si burrat e qëmoçëm. Nga sjelljet dukej se ishte i familjarizuar me mjedisin, banakieren dhe kamerierin. Edhe ata sillleshin si me të shtëpisë. Kafënë te banaku e porositi vetë. U ulëm diku nga mezi i sallës së madhe anash, në sfondin e së cilës ishin nja dy dyshe të huajsh në bisedat e tyre. Sjellja e përzemërt shprehte një lloj kënaqësie. Për intervistën nuk tha tjetër, veç falënderimit. Gazetën nuk e hapi. Mund ta kishte marrë më parë. Kënaqësinë e tij e ndieja edhe në bisedën e zgjatur, gjysmë, apo, tre çerek ore, një kohë e tepruar për të. Më vjen keq që nuk mbaj mend se çfarë biseduam. Afërsisht u vërtitëm te temat e mëparshme. Kafënë e pagoi ai. Këmbënguljen time e shpërfilli pa kundërshtime gojore, duke iu drejtuar me ton autoritar kamerierit, që mua nuk më linte shteg.

Me rastin e botimit të këtyre intervistave, prej të cilave nuk mund të lija jashtë atë të profesor Eqrem Çabejt, mbase, e vetmja e tij, dhe ndihmesën e profesor Mahir Domit, tanimë, pas afro tridhjetë e pesë vjetëve, që fjala e dhënë nuk prish punë, po e them të vërtetën e historisë së paharrueshme për mua, në shenjë nderimi për të dy gjuhëtarët e mëdhenj, që shquheshin edhe për mirësjellje e fisnikëri, secili sipas etikës së vet.

Tiranë, korrik 2013

\* \* \*

Në rrethana krejt të tjera, në pluralizëm, në vitet 1997-2001, duke qenë kryeredaktor i revistës *Universi Shqiptar i Librit*, kam kryer me shkrimtarë, gjuhëtarë e përkthyes, pjesën më të madhe të intervistave, që janë përfshirë në këtë libër. Përmbushja e këtij pasioni më ka dhënë kënaqësi të veçantë, prandaj, i jam mirënjohës botuesit të revistës *Universi Shqiptar i Librit*, z. Fatmir Toçit, që më besoi dhe më lejoi ta sendërtoj në liri të plotë, po ashtu, edhe zonjës Irena Toçi, drejtore e Shtëpisë Botuese *Toena*, e cila pranoi pa mëdyshje botimin e tij.

NJËSIA GJUHËSORE  
PASQYRON NJË NJËSI KULTURE

*Tri pyetje prof. Eqrem Çabejt  
rreth studimeve etimologjike në fushë të shqipes.*

***Studiuesit dhe publiku ynë para ca kohësh patën në dorë veprën tuaj “Studime etimologjike në fushë të shqipes”, vëllimi i dytë. Ne mësuam se së shpejti Ju do të dërgoni në shtyp vëllimet 1 dhe 3 të kësaj vepre madhore me aq rëndësi për historinë e gjuhës dhe të kulturës sonë në përgjithësi. A mund të na thoni dy fjalë lidhur me përmasat e kësaj vepre dhe strukturën e saj?***

Sikundër e thoni edhe Ju vetë, nga vepra *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, që po botohet nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë sonë të Shkencave, në vitin 1976 ka dalë vëllimi i dytë, që përmban fjalët e shkronjave A e B dhe që është pajisur edhe me një përmbledhje fjalësh frëngjisht e me indekse fjalësh. Kam dorëzuar para disa kohëve vëllimin e parë edhe të tretin. I pari, Hyrja e gjithë veprës, përmban shqip e me përkthim tërësor frëngjisht, parimet dhe metodën e ndjekur në gjurmimin etimologjik të elementëve që përbëjnë pasurinë leksikore të gjuhës. Aty jam nisur nga vetë lënda e shqipes, duke i vështruar çështjet, që dalin në atë mes, nga rrethanat e brendshme të gjuhës: me bindjen që objekti, e me të bashkë dhe materiali, përcakton shpeshherë edhe metodën e punës. Ky vëllim, i cili përmban dhe shkurtime bibliografike të caktuara prej meje gjatë punës, si edhe indekset e fjalëve, ka marrë formën përfundimtare dhe është gati për shtyp. Parimet dhe metoda e punës, të parashtruara në Hyrje, shfaqen në mënyrë konkrete në vëllimet e gjithë serisë, si në atë që është botuar, si në vëllimet që do të ndjekin në të ardhmen. Nga ato, vëllimi i tretë, që, siç u tha, edhe ky është dorëzuar prej meje, përmban fjalët e shkronjave C, Ç, D, DH, përveç përmbledhjeve frëngjisht dhe indekseve të fjalëve. Struktura e veprës është e tillë, që mbarë vepra mendohet të



përfshijë disa vëllime, pas parashikimeve rreth tetë e mbase edhe ndonjë më shumë. Mënyra e paraqitjes së lëndës do të jetë e njëjta në të gjitha vëllimet.

***Lexuesit e vëllimit 2 “Studime etimologjike në fushë të shqipes” kanë vënë re se duke u mbështetur në një konceptim të gjerë, të ri, të studimeve etimologjike, janë arritur rezultate me rëndësi në fushën e studimeve të gjuhës e të kulturës sonë. A mund të na thoni diçka për këto koncepte dhe parime shkencore, që janë vënë në bazë të studimeve etimologjike dhe për mundësitë që kanë krijuar ato për të arritur në sqarime dhe zgjidhje të reja të burimit dhe të historisë së fjalëve të gjuhës sonë?***

U përmendën më sipër objekti, materiali, parimet e metoda e punës që ndiqet në këtë fushë studimesh. Këto, siç u tha, janë të lidhura dhe kushtëzohen në mes të tyre. Dihet lashtërisht që etimologjia është dija që studion burimin e fjalëve. Në konceptin modern të zbatuar në këtë lëmë kërkimesh, etimologjia, ndërkaq, përfshin një fushë më të hapët. Ajo duhet të rrokë historinë e elementeve përbërëse të leksikut të gjuhës në vështrimin më të gjerë të asaj fjale. Shtrohet detyra të ndiqet filli i jetës së fjalëve, fatet dhe zhvillimi i tyre në hapësirë e në kohë. Aty, ndërkaq, do pasur përherë parasysh që fjalët e një gjuhe nuk kanë ekzistuar e nuk ekzistojnë kurrë në vetvete. Në të vërtetë janë njerëzit që e kanë folur e që e flasin gjuhën, e që kanë përdorur e përdorin fjalët e sistemit të saj. Kështu, elementet leksikore, fjalët, nuk mund të merren të shkëputura nga shoqëria dhe nga kushtet e saj ekonomike e kulturore. Duke i shikuar këto të gjitha - ashtu si edhe duhet - nga këndi i vështrimit të rrethanave vetjake të gjuhës shqipe, kërkimet etimologjike dhe rezultatet e tyre marrin një rëndësi të veçantë përbrenda gjuhësisë dhe përgjithësisht brenda lëmit të shkencave shoqërore. Dihet se shqipja ndër gjuhët motra të Europës është e dokumentuar me shkrim relativisht vonë, në gjendjen e sotme të njohurive tona në këta pesë shekujt e fundit e këtej. Dihet më anë tjetër që ajo paraqet një ndër gjuhët e lashta të kontinentit. Këtë realitet të dyfishtë duhet ta kenë parasysh historia gjuhësore përgjithësisht dhe përbrenda saj etimologjia në veçanti, dhe t’i përgjigjen në mënyrë shkencore objektive. Kjo vlen si në konceptimin, në rrokjen e kësaj problematike në përgjithësi, si në punë të zbatimit të saj në gjurmimet etimologjike të gjuhës. Aty e ka burimin dhe metoda e punës, e cila, siç u tha, kushtëzohet dhe nga objekti e nga materiali. Aty, për t’u ngjitur në disa shkallë më të moçme të gjuhës, ndihmojnë kryesisht dy lloj burimesh gjuhësore. Më një anë janë

përmendoret e vjetra të shkrimit, duke nisur nga ato të epokës kastriotiane e duke zbritur në kohë. Më anë tjetër është lënda e gjallë e gjuhës sot dhe e dialekteve të saj, brenda trojeve ku flitet shqipja dhe nëpër ngulimet e përhapura brenda e jashtë Gadishullit Ballkanik. Kjo lëndë gjuhësore, ndonëse nuk është mbledhur ende tërësisht, paraqitet në ditë tona shumë më e pasur nga sa dihej sot e një shekull më parë. Ky rezultat është arritur kryesisht me punën e palodhur të vetë shqiptarëve në Shqipëri dhe nëpër viset e ndryshme ku flitet shqipja. Letrarë, arsimtarë e dashamirë të tjerë të gjuhës amtare kanë punuar, në kohët e kaluara, me vetëmohim, e shpeshherë në kushte të vështira, në mbledhjen e dokumentimin me shkrim të lëndës gjuhësore. Një punë më e thelluar, më sistematike, e me kritere shkencore më të shëndosha, është kryer e vazhdon të kryhet te ne në epokën e Pasçlirimit nën kujdesin e pareshtur të Partisë. Krahas me këtë punë ka shkuar e po shkon dhe mbledhja e emrave të vendeve, e toponimisë, ku ruhet një pjesë e moçme dhe e paregjistruar e pasurisë leksikore të gjuhës.

Duke u mbështetur sidomos në këto të dhëna për një pjesë të mirë, të paditura më parë e për dijen, prandaj shumë herë të reja, ka qenë e mundur të arrihet në një fazë gjuhësore më të vjetër, ku dialektet kanë qenë më afër ndaj njëri-tjetrit, si dhe ndaj tipit të përbashkët të gjuhës. Në atë fazë mjaft fjalë dëshmohen me një trajtë ose me një kuptim të ndryshëm nga trajtat a kuptimet e sotme. Me këtë rrugë edhe historia e tyre paraqitet shpeshherë në një dritë të re. Ashtu mundësohet hetimi i trajtës, a domethënies së kryehershme të fjalëve, dhe me këtë rast lehtësohet dhe diktimi, gjetja e burimit të tyre. Një ndihmë të mirë na japin në këtë mes të dhënat e dialekteve të diasporës shqiptare, të ligjërimeve sidomos të Greqisë e të Italisë; të shkulura para disa shekujve prej trungut të përbashkët të gjuhës, ato ruajnë shpeshherë tipare gjuhësore më të moçme. - Më e vështirë paraqitet puna e gjurmimit etimologjik kur dëshmitë e vjetra, shkrimore a gojore, mungojnë. Aty kërkimtari detyrohet të dalë jashtë caqeve të shqipes. Ndërsa gjer aty mjaftonte krahasimi i brendshëm, krahasimi midis dialekteve ose ndërmyjet dialekteve dhe burimeve shkrimore, tashti ndërmerren krahasime të jashtme, midis shqipes dhe gjuhëve të afra (farefis) me të, krahasimeve të fushës indoeuropiane. Në atë mes dalin në shesh tipare që dëshmojnë karakterin vetjak edhe të lashtë të shqipes në rreth të idiomave të kësaj familjeje gjuhësore. Shihet këndej rëndësia që merr etimologjia shqiptare edhe për gjuhësinë e përgjithshme indoeuropiane. Gjithashtu në mënyrë të veçantë dhe për hetimin e gjuhëve ballkanike të lashta, të zhdukura gjatë kohëve, e për gjuhësinë ballkanike në përgjithësi. Metoda e gjurmimit aty, përveç krahasimit, është edhe rindërtimi, diktimi

i disa tipareve të padëshmuara në mënyrë konkrete. Aty puna e gjuhëtarit i përngjan asaj të arkeologut. Edhe ky nga disa mbeturina rrënojash, nga ndonjë hark, nga disa shtylla mbetur më këmbë, rindërton një tempull a një pallat të kohëve të lashtësisë.

Gjurmimet etimologjike përveçse për historinë e gjuhës janë me peshë edhe për historinë e popullit dhe historinë e tij kulturore. Populli shqiptar është trashëgimtar i një kulture ballkanike të lashtë. Elementet e leksikut të shqipes, të hetuara në historinë e tyre hapin shtigje për të gjurmuar elementet e kulturës popullore e të zhvillimit të saj në rrymë të kohëve. Me gjithë afrimet që ka me kulturat fqinje, kjo kulturë përmban tipare vetjake. Dhe ajo jo vetëm ka marrë prej sosh, po edhe u ka dhënë atyre nga elementet e veta, gjë që gjër më sot nuk ka qenë vënë në dukje sa duhet. Gjurmimet etimologjike janë një mjet në këtë mes për të nxjerrë në dritë këto rrethana.

Studimet etimologjike të shqipes kanë një traditë mjaft të pasur. Përveç dijetarëve të huaj, që gjuhësia shqiptare i vlerëson si duhet, do të theksohet se edhe mjaft gjuhëtarë vendës kanë lëvruar këtë fushë studimesh. Pa mundur të përmendim të tjerët, do të themi se një vend të veçantë zënë aty Kostandin Kristoforidhi dhe Aleksandër Xhuvani. E nga vargu i gjatë i arbëreshëve të Italisë sidomos Dhimitër Kamarda edhe Marko La Piana.

***Nga studimet në këtë fushë, a dalin të dhëna me interes që dëshmojnë për njësinë e gjuhës e të kulturës sonë kombëtare në periudhat e ndryshme të historisë? Gjurmimi i historisë së fjalëve ç'na tregon për traditat e gjuhës sonë të shkruar dhe për punën e frytshme të zhvilluar nga autorët tanë për përpunimin dhe pasurimin e vijueshëm të saj?***

Burimet kryesore për studimin e fjalëve të gjuhës në zhvillimin e tyre historik janë, sikundër u tha, shkrimet letrare, sidomos ato më të vjetrat, edhe gjuha e gjallë me dialektet e saj. Të dyja këto burime japin dëshmi për karakterin e njësisë të gjuhës dhe bashkë me të edhe të kulturës popullore. Ka forma fjalësh që janë të barabarta në ligjërimet e Kosovës dhe në Çamëri, kjo për arsyt e ditur në gjuhësi, që në një truall gjuhësor të caktuar anët, skanjet, ruajnë tipare më të lashta. Gjithashtu ka forma dhe kuptime fjalësh të dialekteve veriore e të autorëve të vjetër të Veriut, që janë të ngjashme me ato që ndeshen në ligjërimet arbëreshe të Greqisë a të Italisë dhe të shkrimtarët e tyre. Këto të gjitha dëshmojnë për një njësi brenda ndryshimeve. Njësia gjuhësore ndërkaq pasqyron një njësi kulturore. Me gjithë ndryshimet krahinore që shfaqen, si kudo, edhe

përbrenda trevave shqiptare në këtë fushë, një dije në vështrimin e mirëfilltë të fjalës, një etnografi e një sociologji objektive nuk mund të mos vënë re karakterin në analizë të fundit të njësisishëm të kulturës popullore. Si në kulturën materiale, si në kulturën mendore të popullit tonë, ka elemente të përbashkëta të pamohueshme. Ato integrohen në një bashkësi më të madhe ashtu si integrohen dialektet në bashkësinë gjuhësore. Studimi historik i gjuhës, gjurmimet etimologjike të kryera në formë objektive, u japin në këtë mes studimtarëve të fushave të ndryshme një mjet në dorë për të rrokur disa nga tiparet qenësore, esenciale të kësaj kulture. Kuptohet vetvetiu që kjo është me peshë edhe për kërkimet në lëmin e historisë.

Në lidhje me këto, më së fundi, do vënë në pah se tradita letrare dhe pasuria dialektore që u zunë n'gojë më sipër, nuk janë dy fusha qenësisht të ndara njëra nga tjetra. Shkrimtarët shqiptarë, duke nisur që me autorët e vjetër, e mbase dhe me të tjerë që mund të kenë vepruar përpara tyre, kanë marrë vazhdimisht fjalë nga gjuha popullore. Ata shpeshherë i kanë përpunuar ato, i kanë shtënë në përdorim në veprat e tyre dhe i kanë ngritur ndonjëherë në një sferë kuptimore më të lartë. Kjo veprimtari ka vijuar pa ndërprerje dhe më vonë, ndonëse me përmasa më të vogla, edhe në shekujt para shkrimtarëve të Rilindjes. Këta ndërkaq, si në Shqipëri - edhe më parë - në Itali, duke u mbështetur dhe në traditën e mëparme, e kanë vazhduar këtë rrugë me frymë të vetëdijshme e në mënyrë të thelluar. Këtë rrugë po ndjekin edhe shkrimtarët e sotëm, me veprat e tyre në poezi e në prozë. Ata përveçse frymëzohen nga gurra e pashtershme e poezisë dhe gjuhës popullore, me drejtimet e dhëna nga Partia, synojnë edhe në pastrimin e kësaj gjuhe prej ndikimit të huaj dhe në pasurimin e saj të vazhdueshëm.

Eqrem Çabej

*Drita*, 9 shtator 1979

## ROMANI DOLI NGA ALBUMI PËR MIQTË

*Me shkrimtarin Dritëro Agolli për romanin  
“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”.*

### ***Ku është fundi i paradokseve?***

*Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*, që është një nga romanet më origjinalë të letërsisë shqipe, është shkruar pa një paramendim krijues, pa një ide krijuese paraprake, si pohon vetë autori. Një vepër e rëndësishme pa një mendim krijues paraprak! Ky është paradoksi i parë.

Fillimisht është botuar te revista *Hosteni* (1972) në formën e një novele satirike jo fort e njësuar, pastaj merr fytyrën e romanit, duke dalë libër më vete (1973). Nën censurën e realizmit socialist nuk ka qenë botuar as më parë dhe nuk u botua as më pas një ironi kaq e thellë ndaj sistemit totalitar. Vepra të tilla ndaloheshin menjëherë, ndërsa mbi autorin binin rrufetë e Zeusit që nga Olimpi shtetëror. Ndoshta, nga situata tepër goditëse e plenumit të 4-të (1973) ndaj shkrimtarëve, mbi Dritëro Agollin jo vetëm që nuk ra rrufeja (disa doemos do të shpëtonin dhe do të mirëtrajtoheshin), por, përkundrazi, në këtë vit i erdhi kali i bardhë i fatit dhe u bë kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë (patjetër dikush do të bëhej edhe kryetar, madje do të ishte nga më të njohurit). Ky ishte paradoksi i dytë.

Romani fitoi menjëherë miratimin e madh publik, më tepër gojarisht. Gjatë 18 vjetëve (1972-1990) është shkruar për të vetëm një shkrim, dhe një tjetër më 1993-shin. Nuk është ribotuar deri më sot, veçse kur u përfshi në veprën shumëvëllimëshe të autorit. Mirëpo, më 1978-n botohet në Bullgari, më 1990-n në Francë prej Gallimard-it, e, me radhë në Gjermani, Rusi, Itali, Greqi. Ky është paradoksi i tretë.

Më 3.11.1984, në hollin-kafe te hotel *Tirana*, sot *Tirana International* në katin e dytë, dhe më 7.1.1985 në bar-restorantin e ashtuquajtur *Taivan* (tanimë i prishur, në vend të tij është Kompleksi *Taivan*, shënim i

mëvonshëm), në ish-lulishten e madhe para hotel *Dajtit* kam zhvilluar këtë bisedë me shkrimtarin Dritëro Agolli, i cili, edhe pse autor i famshëm dhe kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve, me mirësjellje dhe sinqeritet iu nënshtrua “dëshirës” së një redaktori të gazetës *Drita* për një bashkëbisedim krijues.

Në vitet 1980 kaq herë kam dashur ta publikoj në revistën *Nëntori* dhe në gazetën *Drita*, por kryeredaktorëve, për çudi, u dukej elozh ndaj kryetarit (pse, pikërisht, për *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo* dhe jo ndonjë vepër tjetër këtë nuk e shpjegoj dot as tani), prandaj mbeti në dosjen time. Më vonë, kur shkrimtarit i atribuoheshin shumë mëkate, si për druajtjen time, pasi isha i bindur që organet letrare nuk do ta mirëprisnin, ashtu edhe se kisha dëshirë të lexohej me paanësi politike, as nuk mora mundimin t’ua ofroj. Pra, biseda del në dritë pas 14 vjetësh. Ky është një tjetër paradoks që ndoqi “*Zylon*” dhe dëshirojmë të jetë i fundit, pavarësisht se nuk besojmë të ndodhë kështu.

***Si lindi ideja? Cilat kanë qenë problemet, tipat konkretë dhe ngjarjet që ju frymëzuan? Qysh në fillim roman e keni menduar veprën?***

Kam njohur shumë njerëz të ngjashëm me *Zylon* në mjediset e nëpunësve, të intelektualëve. Po kishim edhe një në *Zëri i Popullit*, që e njihja mirë. Ishte shpirt mirë, nuk bënte keq, por ishte shumë vanitoz. Vjen, p.sh., një ditë e më thotë: “Kam një djalë shtatë vjeç. Ka bërë një simfoni...”, ose, merrte gruan në telefon nga zyra dhe e pyeste: “Si është Stradivarius? Ç’bën?”, pastaj kthehej nga unë dhe më thoshte: “I kam thënë gruas mos ta lërë të kompozojë shumë, se do të dëmtohet”. Ky ishte një tip letrar i gatshëm. Mbaja shënim bëmat e këtij tipi. Një ditë mendova që me to të bëja humor për rrethin e shokëve të mi, për të afërmit, si mbajnë shënim pleqtë biografitë e tyre për t’ua lënë kujtim nipave që të mos harrojnë origjinën. I mbaja shënimet që të bëja një album humoristik për njerëzit e afërt, për të qeshur dhe nuk mendoja për vepër letrare, aq më pak për ta botuar një ditë. Gruaja ime, kur më shihte më thoshte: “Ç’i do këto? Kujt i duhen? Pse merresh me gjëra të kota?”.

Kisha shkruar rreth njëqind faqe, kur një ditë më vjen në shtëpi Niko Nikolla. Atëherë sa ishte bërë kryeredaktor i revistës *Hosteni*. Më kërkoi diçka për të botuar se “donte që t’ia ndërronte faqen revistës”. Unë s’kisha ndonjë gjë për të dhe i tregova shënimet për të qeshur. Ai më tha: “Do t’i marr t’i botoj”. “Jo, - i thashë, - nuk i kam për t’i botuar”. Por ai i mori dhe filloi t’i botojë. Kështu hyra në valle dhe u detyrova ta shkruaja romanin. Bile, qëllori atëherë që vajta në Kosovë dhe isha i detyruar të punoja.

Shpesh mendoja: “Po sikur të sëmurem, ç’do të bëhet me Zylon?”. Për fat nuk u sëmura. Po, një ditë, papritur më lajmëruan nga Ministria e Jashtme se do të shkoja me një delegacion në Kongo. “Po Zylos, mendova, si do t’i bëhet? Ai vazhdon të botohet në *Hosteni*, me shënimin poshtë: ‘vijon në muajin e ardhshëm!’. Unë kam material vetëm për tre-katër numra! Do ta vazhdoj në Kongo!” Dhe kështu nja dy-tre kapituj i shkrova në Kongo. Ja, kështu vazhdonte të botohej numër pas numri dhe unë shkruaja për të mos më gjetur pa gjë në dorë shënimi: “vijon në...” Tani tek e kujtoj këtë peripeci me shokun Zylo më vjen për të qeshur. Edhe historia e të shkruarit është humor më vete.

Pasi u botua në *Hosteni* e mora dhe punova mbi të, në fletët e revistës sikur të isha korrektor. Ato fletë i kam ruajtur ashtu siç janë, të ripunuara. Dhe dua të them se po të mos kishte dalë në revistë zor se do ta nxirrnin si libër, pasi e dimë që redaktorët kanë koncepte skematike dhe burokratike. Kur vajta në Shtëpinë Botuese me librin, si dëshmi për t’i bindur, me vete kisha marrë edhe revistën, sepse kisha frikë se mos nuk ma botonin. Sa doli romani pati reagime të menjëhershme. Disa e pëlqyen, disa nuk e pëlqyen, kurse disa të tjerë e kundërshtuan. Pati reagime sidomos në Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës. E pritën me këmbët e para sidomos ata që në shumë veçori të Zylos gjenin vetveten. E lexoi edhe Mehmet Shehu. Ai ishte operuar atëherë në Francë dhe kishte kërkuar t’i dërgonin numrat e *Hostenit*. Kur ra rasti të më takojë më tha: “Ma ke bërë administratën përshesh!”. “Jo, - i thashë. - Unë kritikoj.” U çudita që rinia e pëlqeu menjëherë. Edhe tani e pëlqen dhe e lexon shumë. Kur doli romani 25 mijë kopje, thashë me vete se do të mbetej librarive, por u zhduk menjëherë<sup>1</sup>.

### ***Cilat janë bëmat reale të Zylos? Çfarë i janë shtuar e përpunuar?***

Ju thashë që tipin e kam real. Shumica e bëmave të tij janë reale, edhe detaje dhe hollësi të shumta, por jo nga një njeri i vetëm. P.sh., Th. D., në

---

<sup>1</sup> *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo* është botuar në revistën *Hosteni* prej numrit 3 (694), 1972, deri në numrin 22 (713), 1972, te *Këndi i novelës sonë*, shoqëruar me shënimin “Shkrimtari Dritëro Agolli mbaroi së shkruari novelën satirike *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*, në të cilën pasqyrohet tipi i një njeriu vanitoz dhe mendjemadh. Revista jonë po fillon ta botojë në disa numra me radhë.” Reagimet e lexuesve ishin të menjëhershme, prandaj, pas tre numrash, për të shmangur keqkuptimet, autori ka vënë sqarimin “Çdo ngjashmëri me ngjarje e njerëz është e rastit”. *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*, roman dhe libër më vete, u botua më 1973.

Ministrinë e Arsimit e të Kulturës mblodhi dymbëdhjetë rapsodë nga veriu dhe u thoshte se “ju jeni të pagabueshëm, vetëm ju dini të bëni poezinë e vërtetë etj.”. Edhe ndonjë redaktor në Shtëpinë Botuese *Naim Frashëri* me këtë gjuhë fliste. “Këta e bëjnë poezinë e vërtetë, - thoshte për rapsodët. - Me këta jam i sigurt, se të tjerët, domethënë poetët, m’i kalojnë minat nën vete”.

Një fakt real tjetër: Do të bëhej përvjetori i një punonjësi në Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës. Me këtë rast do të fliste eprori i tij dhe i kërkoi atij që t’i bënte fjalën e rastit. E, si do ta bënte ai fjalën e rastit për veten e tij?! Vetëm atëherë e kundërshtoi eprorin. Po këtë nuk e vura në roman se do të dukej e pabesueshme. Jeta ka shumë gjëra të forta që po t’i futësh në letërsi duken të pabesueshme.

Po edhe veçoritë e dy kritikëve Zaim Avazi dhe Mitro Karapataqi i kam marrë nga njerëz konkretë. Marifetet që bëjnë dy kritikët në roman, ata i bënin vërtet. Sot jepnin një mendim për një vepër, nesër kishte ndodhur që kishin shfaqur mendime të kundërta me të parat, sipas opinionit që mund të jepte njëri ose tjetri titullar, apo dëgjonin arsyetime për letërsinë në biseda dhe i mblidhnin e bënin artikuj.

***Po, mirë, nuk ju “vriste” ndërgjegjja se ua nxirrnit të palarat disa kolegëve tuaj, aq më tepër që ndonjëri nuk ishte i keq në shpirt?***

Kjo më shqetësonte, po i kam ndryshuar, kam lënë kryesoret. Pastaj tipa të tillë janë të përhapur dhe, kështu, ngatërroheshin mendimet dhe tiparet e tyre me të të tjerëve. Secili thotë është filani dhe jo unë. Ia lexoja romanin prototipit dhe kënaqej. Kishte njerëz që e ngacmonin, që i thoshin: “Je ti, ç’qesh?”. Ai ua kthente: “E pse jam unë? Ku merrni vesh ju nga letërsia!”. Veç kësaj, edhe personazhet, Zyloja e Demka marrin nga njëri tjetri, me një fjalë, “ngatërrohen”, humbasin gjurmët e prototipave. Kjo ndodh edhe midis Don Kishotit dhe Sanço Pançës, që ndërrojnë rolet me njëri-tjetrin.

***Kemi mendimin se Zyloja do të ishte i plotë edhe pa një Shemshedin që del disa herë. Po, a do të mjaftonte Zaim Avazi pa Mitro Karapataqin? Ata kanë edhe cilësi që, si të thuash, me to përsëdytin njëri-tjetrin.***

Mitrua me Zaimin i duhen njëri-tjetrit, sepse rivalizojnë që kush të gjejë i pari mendimin e titullarit. Ai edhe fiton. Dhe në fund të romanit, kur Zyloja bie, kush e kush të largohet më parë e të lidhet me Aranitin. Ai që



është më i zgjuar gjen mendimin e shokut Q., që është më lart, kurse tjetri mbeti me Zylon.

***Si i keni bërë tërë ato lojëra fjalësh në gojën e dy personazheve kritike, tërë ato fraza të ngatërruara që të bëjnë të të zërë koka?***

I kam marrë të gjalla nga disa raporte pune, nga shkrime të dy-tre kritikëve. Merri e lexoi! Po, ashtu janë. Mora disa të tilla dhe i vura në gojën e personazheve. Ja, lexo se ç'thuhet në një raport të drejtorisë së *Teatrit të Operës dhe të Baletit* që është paraqitur këto ditë: “Po punohet që koncerti i Ansambllit (të Këngëve dhe të Valleve Popullore) të jetë koncert spektakël rreth temës së ujit, si burim i pashtershëm jete, energjie etj. Që në epokën e Partisë është shfrytëzuar më së miri në dobi të transformimit socialist të vendit”. Pra, një gjuhë banale, teknokratike në trajtimin e çështjeve të artit. Tema e ujit në valle! E shikon se ç'të shprehur? Ç'marrëzi?! Ja, ku i gjej. Të tilla, sipas origjinalit në *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo* kam vënë tri-katër faqe, se këto nuk i krijon dot, s'ka burrë që t'i formulojë kështu!

***Po esetë e Zyllos si janë bërë?***

I kam bërë vetë. Ato janë eklektike, diçka e mirë, pastaj diçka absurde, që mendoj se i shkojnë natyrës së tij.

***Po, se ai është kompleks. Këtu thotë diçka të mençur, pastaj diçka të kundërt që të çudit. Mirëpo, si i bën shkrimtari këto lloj paravolish, që shumë herë janë alogjike?***

Unë bëj vazhdimisht esera, edhe të këtij lloji, të cilat i përdor kur më duhen. Nisemi nga parimi që asnjë ditë pa një radhë. *Nula dies sine linea*, thotë latini.

***Araniti a mund të ishte personazh më satirik? A mund të dilte më tepër?***

Të thashë si e kam shkruar, pra, pa qëllime botimi, pa “censurë të brendshme”. Mirëpo, pasi e botova nuk e ndryshoja dot më. Kështu që romani ka natyrshmëri, por ka edhe dobësi. Araniti mund të ishte më satirik. Duhej të hynte në atë që unë i them garë komike me personazhet e tjera, domethënë të fliste me gjuhën e satirës e të humorit. Por nuk e

kam menduar roman satirik që në fillim, prandaj ky personazh ka dalë i tillë. Kjo, mbase, është edhe dobësia e tij. Në botimin e Veprës Letrare jam munduar ta rregulloj, por nuk e kam rregulluar edhe aq sa duhet. Në botimin e ri do të shoh përsëri që ta rregulloj. Në krahasim me botimin e parë, në këtë dhjetëvëllimëshin kam bërë një plotësim të karaktereve.

Po Araniti nuk është pa të meta. Ky nuk mund ta ndreqë gjendjen dhe as Zylon, se është nihilist, brutal, arrogant, se i janë mërzurit të gjitha. Fajin për këtë e ka Zyloja, sepse nga gjendja që është krijuar, atij nuk i pëlqen asgjë. Me inatin e tij lexuesi mund të mos qeshë, por buzën në gaz e vë.

### ***Ku qëndron e keqja shoqërore më e madhe te tipi i Zylos?***

Ai është i vetëkënaqur, nuk kërkon të shkojë më tej. Përvoja e kaluar e të tjerëve, tani, sipas tij, duhet të jetë e vetmja mënyrë pune, pra, duhet të dogmatizohet. Prandaj, çdo novacion, çdo kërkesë të re për punë, për të ecur përpara e quan të tepërt. Konceptet e tij dogmatike duken qartë edhe në metodën dhe stilin e tij të punës. Të dhënat për një gjendje apo situatë të caktuar do t'i përgjithësojë, t'i paraqesë si ligje, që, në fakt i dogmatizon njohuritë dhe mendimet si për punën ashtu dhe për shoqërinë. Më parë ka qenë drejtues revolucionar, prandaj edhe mburret me të kaluarën, por, tani, ka mbetur në vend, e ka zënë meningjiti i burokracisë dhe i stanjacionit. Ai është ambientuar me gjendjen, me mesataren e njerëzve, nuk është as drejtues, sepse është nën nivelin e vartësve. Po i mungon edhe shpirti krijues e kërkues që ka njeriu i vërtetë. Realisht nuk njeh as të kaluarën e as të sotmen.

E metë tjetër, që e bën të arrijë në atë shkallë, është vaniteti i tij. Ai është tip vanitoz. Kur shkon në fshat, duket sikur i del pija e euforisë burokratike, se kthehet në fëmijërinë e dikurshme. Edhe në ndonjë vend tjetër bëhet realist dhe objektiv. P.sh., habitet nga Zaim Avazi që ndërron faqen, habitet nga ata që kthejnë fletën, sepse për vete nuk toleron dhe nuk shkel mbi ato që i quan parime dhe nuk dredhon, nuk do të gënjejë me vetëdije. Dhe përsëri bëhet absurd...

### ***Ç'vështirësi keni pasur për të arritur koherencën e veprës, aq më tepër që nuk e kishit konceptuar të tillë qysh në fillim?***

Sa herë i kam prishur skenat ku del Araniti! Një herë mendova ta bëja njeri të zakonshëm që t'i kundërvihej, por më dilte moralizues, didaktik dhe nuk e përballonte dot Zylon, sepse nuk e kishte peshën e duhur shoqërore. Një herë Shemshedinin mendova ta lija bashkë me Zylon

në një mjedis, por më nxirrte telashe se do të përsëritnin njëri-tjetrin e sidomos do të ma vështirësonin zgjidhjen e problemit. Në këtë mënyrë nuk do të kishte as humor. Prandaj Shemshedinin e dërgova në Tepelenë, me qëllim që dikur të takoheshin. Mundim i madh për mua ka qenë ndërtimi origjinal, i papërsëritshëm i figurave, se shumica e tyre ishte e panjohur në letërsinë tonë. Vështirë e kam pasur me figurat e rapsodëve. Atëherë u ngrit me të madhe e me të drejtë mbështetja e thellë e artit tonë në krijimtarinë popullore, por prej disave u teprua dhe u absolutizua, u kalua në njëanshmëri. Të kritikohesh ky teprim, në ato situata, ishte e vështirë, sepse dogmatikët e burokratët që prekeshin në roman do të mundoheshin të spekulonin, gjoja në mbrojtje të parimeve. Prandaj, për këtë dhe për hir të së vërtetës vura një rapsod pozitiv.

Shqetësuese ishte çështja e fabulës, kurioziteti ndaj saj. Lexuesi duhej të dinte diçka, por diçka duhej t'i lihej edhe në mjegull, në pritje, se ç' do të bëhej me Zylon. Prandaj duhet thënë që në fillim. Historia me Kleopatren është një mjet për ta joshur lexuesin. A do të bëjë dashuri me ndonjë grua tjetër? Po posti zyrtar që ka? Jo, Zyloja nuk mund të bëjë dashuri megjithëse ia do zemra.

Në konfliktin e madh shoqëror ballafaqohen Zyloja me Demkën, Zaim Avazin, Mitro Karapataqin, shokun Q. Kemi një konflikt të dyfishtë. Konflikti midis personazheve është për të hedhur problemin shoqëror, por edhe për të mbajtur në tension lexuesin. Shkrimtari dhe rrëfimtari flasin me ironi dhe me seriozitet të madh, sepse të tilla janë problemet dhe zgjidhjet që u duhen dhënë atyre.

Vështirësi tjetër ka qenë se ku do ta shpija të punonte. Ky nuk është shëf çfarëdo dhe një gjë e tillë përbënte vështirësi të madhe. Botuesit thoshin që personazhi të ulej në përgjegjësi, sepse vepronte në një ministri, pra të ishte me një përgjegjësi më të vogël.

***Një koncept i tillë skematik ende vihet përballë veprave. Po, si është kapërcyer praktikisht mundësia e keqkuptimeve që mund të vinin nga këto koncepte skematike? Si është pranuar vepra edhe prej atyre që e kuptojnë në mënyrë të thjeshtëzuar letërsinë?***

Për këtë luan rol opinionin shoqëror pozitiv që jepet edhe në roman...

Jeta vetë ka afirmuar më tepër se çdo gjë tjetër vlerat e romanit, ka nxjerrë në pah, ka vënë në provë rëndësinë e problemeve dhe vërtetësinë e tipave. Dhe, përderisa lexuesi e pëlqen, do të thotë se këtë provë romani e ka kapërcyer me sukses.

***Demka është, gjithashtu, një tip real dhe figurë përgjithësuese. Çfarë keni gjetur të gatshme te prototipi dhe çfarë keni shtuar nga mendimi juaj krijues?***

Në jetën tonë tipi i Demkës është i njohur. Po në letërsi nuk ka qenë krijuar. Vështirësi ishte për ta intonuar me Zylon. Të ndryshonte, por të kishte edhe afri me të. Ata janë figura simbioze, kanë bërë njëri-tjetrin. Demka sakrifikon talentin dhe i kushtohet Zylos. Romani fillon kur Demkës i zgjohet ndërgjegjja. Ky zgjim është i vonshëm. Për këtë vonesë kemi keqardhje, sepse psikologjikisht ka arritur në atë shkallë që, po nuk e ngarkuan të tjerët me punë angari, nuk i rrihet.

Njëherë mendova ta tregoja ngjarjen vetë si autor. Dmth. veta e parë të ishte autori. Por kështu romani mund të shpërndahej dhe mund të bëhej jo fort i besueshëm. M'u duk më e përshtatshme të fliste Demka. Ky flet me seriozitet të madh, flet me gjithë mend, por i tregon edhe për të qeshur.

Me këtë rast dua të përmend rëndësinë që ka njohja e jetës për çdo vepër. Po të mos njihja sferat administrative të kulturës nuk kisha si ta bëja romanin. Duke njohur sferat e gjëra të jetës, zyrtarë të lartë dhe nëpunës të vegjël, njeh edhe problemet, edhe tipat. Puna e shkrimtarit për njohjen e jetës duhet të jetë e gjithanshme në veprimtarinë prodhuese, në administratë e kudo dhe, kudo të kërkojë, të hetojë dhe të mendojë për letërsinë. Fatkeqësia e disa shkrimtarëve është se nuk mbledhin material të gjallë, se nuk i mbushin plot qeset... Unë për vete, çdo vit hap një fletorkë për material të gjallë, për thënie të ndryshme etj. Sa për personazhin e Demkës jam mbështetur në cilësi të S. A. E kam dëgjuar me veshët e mi, p.sh., kur i thoshte e shoqja që të mos merrte përsipër të bënte raportin për mbledhjen e lagjes. “Nuk do ta marr”, i tha. Pastaj iu kthye mendja se ishte tepër zemërbutë. “Ah, - tha, - s’kam ç’të bëj, nuk ia kthej dot!” E shoqja e vështroi me keqardhje.

Siç e thashë, vështirë ka qenë për mua se nuk ishte paraqitur më parë tipi i tij në letërsi. Po vështirë ishte ta trajtoje edhe në këtë anë, se ka shumë drejtues që ua japin të tjerëve t’i përgatisin materialet me të cilat spekulohet, fshihet paaftësia dhe i jepet krahë lëvdatës së pamerituar. Prandaj me Demkën dhe Zylon u digjte shumë vetave. Unë për veten time pata një të mirë të madhe se nuk më afroreshin më për t’u bërë materiale të tilla.

Problemi, ideja e një tipi të tillë, ka qenë me kohë në mendjen time. Më lindi ideja të bëja ose një artikull, ose një fejtun. Dhe e fillova, por më pas,

mendova ta lë për vepër letrare. Një tip si Zyloja është në tregimin *Portreti i njeriut të madh*<sup>1</sup>, i përmbledhur në dhjetëvëllimshin tim. Ky tregim, si të thuash, është gjeneza e Zylos. Por në tregim mungon personazhi i Demkës.

***Zgjidhja e romanit është e përgjithësuar. Në situatat që paraqiten aty, a mund të ishte më konkrete?***

Në këtë rast nuk gjeja dot zgjidhje më konkrete, më jetësore. Ndofta zgjidhja duhej më jetësore, por konkrete është. Kjo konkretësi lidhet me faktin se të gjitha personazhet mendojnë se ku do të shkojë Zyloja dhe për këtë bëjnë hamendje, bëjnë supozime të ndryshme. Një gjë e tillë i shkon llojit satirik. Me këtë kam manovruar, si të thuash. Romani është disi i pazgjidhur, po të mendosh skemat e atëhershme, që, një kuadër të tillë doemos do ta shpie në prodhim apo do të vijë një zgjidhje tjetër, po kaq e njohur dhe skematike. Kam dashur të jap një zgjidhje, ndryshe nga ato skematiket.

***Me një fjalë, keni marrë një pozicion estetik kundër skemave.***

Po, kjo më tepër është një zgjidhje estetike. Kjo zgjidhje është më jetësore. A nuk ka edhe sot thashetheme për kuadro? Njerëzit thonë se filani do të transferohet këtu e atje, në vend të akëcilit! Prandaj fundi është real, fund me thashetheme. Nuk është skematik. Skematizmi të lë pas, të tërheq nga e kaluara.

***Dihet ç’i dhatë ju lexuesit me “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”. Po ç’ju dha romani dhe lexuesi juve si shkrimtar?***

Unë verifikova bindjen time që e kisha edhe më parë se vepra po pati problem dhe art, në mos në fillim, më vonë do të ketë sukses me siguri. Shkrimtari i njohur gjerman Hajnrh Bël thotë se letërsia është problem, është shqetësim. Kjo më ka bërë shumë përshtypje, kur e kam lexuar nga një shkrimtar i huaj. Problemi i Zylos është një problem me shumë rëndësi, i cili do të jetë aktual për shumë kohë.

Romani *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo* më dha edhe një verifikim tjetër të bindjeve të mia letrare, që letërsia të ketë tipa dhe jetë, të mos jetë sensasionale, sezonale, të mos shkruhet për punë “koniukturash”, si të thuash.

---

<sup>1</sup> Ky tregim është botuar më 1960-n.

Një shkrimtari, po t'i mbetet gjatë një vepër, është sukses për të. Është sukses për të kur tipi i tij bëhet popullor, kur flasin për të. Jetëgjatësia e veprës është sukcesi i tij i vërtetë. Është fjala që vepra të ketë problem kyç, por edhe të dish si ta japësh këtë “kyç”. “Kyçi” është kur problemi është i madh. Ka qindra probleme. Cilin të kapësh, si ta trajtosh?

Sa për mendimin e lexuesve, dua të them se kam dëgjuar mjaft, kam ruajtur letra të tyre që tregojnë se e pëlqejnë romanin. Por më kanë mbetur në mendje veçanërisht qëndrimi i Nonda Bulkës dhe fjalët e Eqrem Çabejt. Nonda sa e lexoi tha: “Satirë me plot gojën!”. Kurse Eqrem Çabej përsëriste shpesh: “Ja, kjo është prozë e vërtetë!”.

***Mendoni që një ditë të merreni përsëri me një Zylo, domethënë të shkruani një vepër tjetër në vazhdim të së parës?***

Edhe të tjerë më kanë ngacmuar për këtë: “Pse nuk e vazhdon këtë roman?”. Sot për sot nuk e bëj dot. Duhet kapur një anë tjetër e këtij problemi. Mund ta bësh, ta vësh në lojë Zylon, sikur qarkulloi dhe u bë, bie fjala zëvendëskryeministër (!) Kjo është më e vështira. Ta bësh, ta zëmë, që të përshkruash e të qeshësh me jetën e Zylos pas rënies nga fiku, kjo nuk ia vlen. Ta bësh si vret mendjen Zyloja se si bëjnë kolegët pa të, si ecin punët pa qenë ai, kjo ka interes, por jo dhe aq, sidomos për një roman. Pastaj, këto lloj vazhdimesh, shumë herë, nuk kanë sukses as në letërsinë botërore.

***Ç’vend zë romani “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” midis veprave dhe dashurive tuaja krijuese?***

Për mua është romani më i mirë.

***Domethënë, është fëmija i përkëdhelur i prindit autor?***

Po, po. Se është jashtë çdo skeme. Edhe Trëndafilin në gotë është pa skema.

*Drita, 23 nëntor 1997*

## **DATAT KRYESORE TË JETËS DHE TË VEPRIMTARISË SË DRITËRO AGOLLIT**

**1931** - (13 tetor) u lind në fshatin Menkulas të Devollit.

**Rizai**, i ati (1891-1966) kishte qenë për një kohë të gjatë emigrant ekonomik në Buenos-Aires (Argjentinë) dhe në Çikago (SHBA) për shkak të borxheve të trashëguara nga i ati. Ai mori pjesë në luftën antifashiste, madje, ishte dhe kryetar i Këshillit Antifashist të fshatit. Dinte përmendësh poezi të Omer Khajamit dhe të Naim Frashërit, që, për të, ishin më të bukurat në botë dhe asnjë tjetër nuk mund të shkruante ashtu.

**Hatixheja**, e ëma (1908-1986) ishte prej Helmësit të Kolonjës.

**1938-1942** - Dritëroi mori mësimet e para në vendlindje.

**1943** - Korier i batalionit partiza *Fuat Babani*. Shpinte letra, njoftime të ndryshme, ushqime, veshmbathje etj.

**1945-1948** - Vazhdon shkollën në qytetin e vogël të Bilishtit.

**1948-1952** - Ndjek mësimet në shkollën e mesme *Asim Zeneli* në Gjirokastrë. Mësuesit e tij ishin: Thoma Papapano, Vehbi Bala, Shaban Demiraj, Luigj dhe Arta Franja për të cilët do flasë shpesh jo vetëm me admirim, por edhe me krenari.

Bashkënxënës me të kanë qenë: Ismail Kadare, Agim Shehu, Bekim Harxhi, Pano Çuka. Për profesorët e përgatitur dhe dobitë e diskutimeve letrare të nxënësve të pasionuar, dikur është shprehur: “*Shkolla jonë në Gjirokastrë ka qenë Akademi letrare*”. “*Gjirokastra ishte porta e parë e madhe, thotë poeti. Atje zbulova botën dhe artin.*”

**1947** - Boton për herë të parë në gazetën *Rinia*, vjershën *Vullnetari i hekurudhës*. Do të vazhdojë të botojë te *Rinia*, *Letrari i Ri*, *Literatura jonë* etj., mirëpo, ëndërronte të bëhej veteriner. Për këtë degë kërkoi të ndiqte studimet e larta. Kahreman Ylli, ministër i Arsimit, e dërgoi për studime filologjike dhe gazetari. Ky vendim, sipas poetit, ndryshoi krejtësisht jetën e tij.

**1952-1957** - Ndjek studimet e larta në San-Petërsburg (Leningrad).

**1952** - Niset me vapor nga Durrësi në Odesa. Ndoqi studimet në universitetin shtetëror *Zhdanov* në San-Petërsburg (Leningrad).

Ka banuar pranë lumit Neva, në *Mitninskaja Naberezhnaja 6, Shtëpia e Studentëve Dom 6*. Profesor ka pasur edhe albanologjen e shquar ruse Desnickaja, si dhe studiuesin me famë botërore Propp, autorin e famshëm të librit *Morfologjia e përrallës*, të akuzuar për formalizëm. “*San-Petërsburgu është porta e dytë, shumë herë më e madhe për mua*”, shprehet ai. “*Nga udhëtimet në Rusi bota m’u bë e pakufishme.*” U dha fort pas Pushkinit, Lermontovit, Çehovit, Tolstoit, Gogolit, Buninit, Dostojevskit etj., posaçërisht pas Bagrickit, të cilin filloi të përkthejë në shqip. Në universitet u njoh me Ehremburgun, Shollohovin, Tvardovskin, Nazim Hikmetin, Jevtushenkon etj. “*Në Rusi, e desha më shumë Shqipërinë. E kuptova më thellë, dmth. dhe poetikisht, pse Naimi në mërgim kishte shkruar aq bukur dhe me aq mall për Shqipërinë. Rusia, shpjegon ai, më bëri më shumë shqiptar.*”

**1954** - Vjen për pushime në Shqipëri, pranë prindërve, por, tanimë, ata ishin vendosur në Sukth (Durrës).

**1955** - Martohet me rusen e bukur Nina Novikova, me të cilën kishte rënë në dashuri. Ajo studionte për gjuhë angleze. U martuan në Bashkimin Sovjetik dhe bënë dasmë ruse.

**1956** - U lind djali, Ariani.

**1957** - Mbaron studimet shkëlqyeshëm. Atë vit morën diplomën shkëlqyeshëm edhe dy rusë dhe një gjerman. Dritëro Agolli bashkë me Ninën dhe Arianin e vogël vijnë në Shqipëri. Nina punoi mësuese e anglishtes në shkollën e mesme *Sami Frashëri*, pastaj, në *Shkollën e Bashkuar*, Tiranë.

**1957** - Fillon të punojë gazetar te *Zëri i Popullit*.

**1964** - Për shkak të prishjes politike të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik, e shoqja, Nina së bashku me të birin, Arianin, largohen përgjithmonë. Dritëroi i përcjell me dhembje të shoqen dhe të birin në aeroport. Drama e tij intime më e madhe.

**1965** - Martohet me Sadije Kecajn, lindur në Shkodër, më 1942 (14 shtator), gazetare dhe shkrimtare.

**1966** - (20 korrik) u lind vajza, Elona.

**1967** - Shkon në Kinë. Poeti mendon se është fat i madh të shkosh në Kinë, sepse është një botë e madhe, e veçantë: edhe natyra, edhe jetesa, edhe



arti, edhe historia (Muri i Madh Kinez). Këto krijojnë shumë asosacione, të nxisin fantazinë edhe kur je atje, edhe më vonë. Për Kinën ka botuar poezi më 1972-shin. Edhe në Kinë është botuar një libër me poezi të tij.

**1969** - (13 mars) u lind djali, Artani.

**1971** - Shkon në Kongo, në kohën kur shkruante dhe botonte të *Hosteni* romanin *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*, të cilin vazhdoi ta shkruajë edhe atje. Kalimthi, për dy-tri ditë shkon në Paris. “Meqenëse kisha lexuar mjaft për Parisin, më dukej sikur kisha qenë, sepse Parisi është qyteti më i njohur në botë nëpërmjet letërsisë. Parisi është personazh në veprën e Balzakut dhe të shkrimtarëve të tjerë.”

**1972** - Është sekretar për letërsinë në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë.

**1972** - Shkon në Kosovë, në fillim në mbrëmjet e poezisë në Gjakovë, pastaj për të lidhur marrëveshje mes dy Lidhjeve të Shkrimtarëve.

**1973-1992** - Është kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë.

**1974-1998** - Është deputet në Kuvendin Popullor.

**1979** - Sërish në Kosovë bashkë me Shefqet Musarajn, Elena Kadarenë, Eglantina Mandinë dhe Zija Çelën.

**1980** - Shkon në Turqi, ku u njoh dhe u miqësua me shkrimtarët e mëdhenj Jashar Qemalin, Azis Nesin, si dhe me shkrimtarë të tjerë me emër brenda dhe jashtë Turqisë, me të cilët ka pasur letërkëmbime, dedikime etj. Ka qenë në shtëpinë e Jashar Qemalit dhe në çiftigun e Azis Nesinit në Stamboll. Afrimi shpirtëror me turqit, natyrisht, është më i madh si për shkak të lidhjeve të gjata historike, të njohjes më të mirë të traditave dhe zakoneve të tyre, ashtu edhe për shkak se atje banojnë qindra mijëra shqiptarë. Prandaj ka shkruar një varg poezish, disa prej të cilave (*Turkeshja, Trëndafilat e turkeshës*) janë ndër më cilësoret.

**1981** - Është i ftuar në Itali për të marrë pjesë në një kongres për pakicat kombëtare në Horë të Arbëreshëve, ku mbajti dhe një kumtesë.

**1983** - Shkon në Francë së bashku me Ismail Kadarenë, Pirro Mishën dhe Dhimitër Shuteriqin. Në Paris nën drejtimin e shkrimtarit, historianit dhe publicistit Eskarpit, u zhvillua një kolokium për letërsinë dhe gjuhën shqipe me intelektualë francezë. Nga mbresat në Paris shkroi poezinë *Në Monparnas*.

**1987** - Bashkë me Androkli Kostallarin, Ismail Kadarenë, Nasho Jorgaqin dhe të tjerë, ishte i ftuar në Palermo po në një kongres të pakicave kombëtare. Atje mbajti edhe një kumtesë. Në kongres ishte Martin Camaj, A. Desnickaja, Ali Podrimja, Rexhep Ismajli, Gani Bobi etj.

**1987** - Nga Italia, bashkë me Ismail Kadarenë shkon në Beograd dhe pastaj në Bor, në veri të Jugosllavisë, në një konferencë për nacionalitetet. Në Bor u njoh me shkrimtarin serb Bullatoviç, nacionalist dhe antishqiptar.

**1990** - Përsëri në Francë, së bashku me Sadijen, me rastin e botimit në frëngjisht të romanit *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*, i cili u prit mjaft mirë nga kritika franceze. “Këtë herë, verifikova ato që kisha lexuar për Francën dhe Parisin, i cili nuk mund të kuptohet pa muzeumet e artit. Parisi është gërshetim i klasikes me modernen si asnjë qytet tjetër. As në Romë, vendi i artit të madh klasik, nuk është një gërshetim i tillë i klasikes me modernen. Muzeumet e mëdha të artit modern janë në Paris, siç nuk janë në Romë.” Në Paris u njoh me Alen Boskenë, Domenik Fernandez dhe Fransua Nurisie.

**1990** - Shkon në Turqi.

**1992** - Shkon në Gjermani me një grup shkrimtarësh: Robert Shvarc, Fatos Arapi, Natasha Lako, Xhevahir Spahiu, Bardhyl Londo, me rastin e daljes në gjermanisht të një Antologjie të poezisë shqipe. Atëherë ishte botuar në gjermanisht edhe *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*, për të cilin u organizua një takim, që u shoqërua me interpretimin e disa pjesëve të zgjedhura. Po ashtu, u zhvillua një bisedë me pjesëmarrjen e shkrimtarëve gjermanë, shqiptarë dhe bullgarë. Dritëro Agollin e intervistoi një gazetar nga ish-Gjermania Lindore.

**1992** - Shkon në Norvegji, ku janë botuar shumë poezi të tij, si dhe romani *Komisari Memo*.

**1994** - Shkon në SHBA së bashku me Sadijen. “*Kur vete në SHBA e ndien veten si të shtypur, shprehet poeti. Vendi i madh, puna e madhe, ushqimi, madje dhe pjatat të mëdha. Poetët shpesh fantazojnë kur shkruajnë për Nju-Jorkun, që është i zhveshur, vetëm me pallate dhe ndërtesa të larta. Atje ka shumë gjelbërim midis pallateve; në tarraca dhe në ballkone të ndërtesave ka lule.*” Atje shkroi dy poezi.

**1994** - Shkon në Itali pasi kishte qenë disa herë, që në vitin 1967. Më 1994-n shkon me rastin e botimit në italisht të romanit *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*.

**1995** - Shkon përsëri në Kinë.

**1996** - Shkon në Greqi. Në ishullin Salaminë organizohet një takim i madh me emigrantët shqiptarë. Në Greqi shkon edhe më 1997-n në një konferencë ndërkombëtare kundër racizmit, ku dhe diskutoi.

**1998** - Qershor, shkon në Francë, me rastin e aktivitetit tradicional për letërsinë *Les belles étrangères*, ku ishin të ftuar trembëdhjetë shkrimtarë shqiptarë. Me rastin e këtij aktiviteti, Dritëro Agollit i ishin botuar dy libra në frëngjisht *Zhurma e erërave të dikurshme* dhe *Njeriu me top* (libër xhepi) nga Shtëpia Botuese *Le serpent à plumes* (Gjarpëri me pupla)<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Skedën e një modeli francez, dhënë nga autori i librit, e ka plotësuar vetë Dritëro Agolli.

KAM SHKRUAR VETËM ATËHERË  
KUR KAM DASHUR TË SHKRUAJ

*Me shkrimtarin dhe përkthyesin Vedat Kokona.*

***Proza juaj realiste psikologjike, nga më të konsoliduarat dhe më interesantet, krahas asaj të Ernest Koliqit, Mitrush Kutelit, Sterjo Spasses, Migjenit, Petro Markos, duket se ka mbetur në formën e dy ishujve me ndërprerje të madhe kohore: “Yje të këputur” (1940), tregime dhe “Me valët e jetës”, roman me dy volume (1961, 1965). A është një prozë e ndërprerë për shkak të rrethanave apo e lënë në mes prej autorit për ambicie të tjera krijuese?***

Ju përmendët *Yje të këputur* dhe *Me valët e jetës* dhe harroni librin tim të parë *Nga Tirana në Stockholm* (1934) që është, për mua, vepër me rëndësi, sepse është e para në gjininë e vet në letërsinë shqipe. A nuk kam të drejtë t’i jap meritën që i përket dhe që i është mohuar gjatë gjysmëshekulli, ashtu si janë mohuar shumë merita të të tjerëve? Meritat e vërteta nuk janë ato që jepen me dekrete, as nga thëniet e papërgjegjshme të kritikëve zyrtarë, por ato që i jep Koha, që s’gabon. Regjimet ngrihen e bien, por merita, në është vërtetë e tillë mbetet. Pra, proza ime ka filluar me këtë vepër, ka vazhduar me *Yjet* dhe me *Valët* dhe meqë yjet dhe valët nuk pushojnë, as proza ime s’ka pushuar. Nga 1934 në 1954 u desh të mblidheshin energjitë e duhura për të krijuar atë roman që priti afro një vit që të botohej, që u botua - çuditërisht! - pa pasur atë “bosht ideologjik” të kohës, që u lavdërua nga kritika zyrtare, që u botua vetëm në 4 000 kopje, kur të tjerat botoheshin në 20 000, që u kritikua në një “forum” të Lidhjes së famshme në Klubin pranë Teatrit Popullor dhe që ka mbetur deri sot si kacabu vrimave sikur ka frikë nga drita. Sa për ambicje krijuese, siç e quani ju, autori s’ka pasur kurrë ambicie letrare. Unë kam shkruar vetëm atëherë kur kam dashur të shkruaj, pa kurrfarë qëllimi. Ose më mirë: vetëm me një qëllim, që shkrimi im t’i bënte një të mirë këtij vendi, të cilit të tjerët po i vënë kazmën. A ka gjë më të bukur?

***A keni pasur plane letrare që ju kanë mbetur vetëm ide?***

Plane jo, por vetë kam mbetur në hava!

***Ç’kishit të përbashkët me Mitrush Kutelin, Sterjo Spassen dhe Nexhat Hakiun me të cilët themeluar edhe gazetën “Revista letrare”?***

Dashurinë për vendin dhe për gjuhën e pasur - e vetmja pasuri e këtij populli shumë të varfër.

***Qëllimin grupi juaj drejtonjës i gazetës “Revista letrare” e ka shpallur që në numrin e parë të saj, 15 shkurt 1944, në editorialin “Në pragon e punës”, ku ndër të tjera thuhet:***

*“Nuk kemi as pikën e dyshimit se të shumtët do të jenë ata që do ta marrin sipërmarrjen tonë si një marrëzi të vërtetë, si diçka anakronike, dhe neve si njerëz që kemi humbur pusullën dhe nuk dimë se ç’bëjmë. Edhe me të vërtetë, të rrisht të merresh me kulturë në një kohë kur bota digjet flakë e zjarr, kur njerëzia e ka humbur konceptin e qetësisë shpirtërore, kur edhe foshnjat dridhen nga ulërime rrëqethëse e sirenavet, i duket tjetrit si një gjë e çuditshme që mund të gjejë shpjegimin e saj në një tronditje patologjike apo në një ekzaltim të tepruar”.*

***Mendoni se e arritët qëllimin me 14 numrat që nxorët?***

Kur të mendoni se *Revista letrare* botohej në një kohë trazirash të mëdha dhe aspak të favorshme për një botim të tillë, do ta çmoni me të vërtetë madhështinë e veprës së atyre që e bënë këtë vepër. Krijimi është si flutura që i vjen rrotull dritës dhe s’pyet në mund të digjet. Po ç’edhe në u djegtë? Krijimi e bën punën e vet! Kush kujtohet për luftën e guelfëve dhe të gibelinëve? Por *Komedia Hyjnore*, që u mbrujt në ato kohë turbullirash, mbeti ajo që ish. Mund të sillja një mijë shembuj të tjerë për t’ju provuar se arti s’pyet as për luftëra, as për murtaja, përmbytje, tërmete dhe, duke fluturuar mbi të gjitha mbetet i përjetshëm.

***Pse u mbyll gazeta “Revista letrare” më 14 shtator 1944?***

Se ishte flutur dhe u dogj nga zjarri.

***Më 1942-shin filluan të dalin gazetat ilegale, të drejtuara nga PKSH-ja. Ju nuk bashkëpunuat me to. Për ç'arsye?***

Do të kisha bashkëpunuar me gjithë shpirt bashkë me shokët e mi po të qe se kryefjala PKSH do të thoshte Për Kombin Shqiptar.

***Në hartimin e fjalorëve frëngjisht-shqip dhe shqip-frëngjisht keni një ndihmesë të pakrahasueshme. Dukeni si një luftëtar i vetmuar në një betejë që s'merr fund. Ç'parime shkencore dhe intelektuale ju kanë prirë në këtë fushë kaq frytdhënëse?***

E quani “të pakrahasueshme” ndihmesën time në hartimin e fjalorëve frëngjisht-shqip dhe anasjellas. S'më vjen mirë t'ju kundërshtoj, por unë s'mendoj kështu. Me sa mendoj unë, këtë punë mund ta kishin bërë nja dy a tre të tjerë që kishin, në mos më shumë, po aq merita sa edhe unë për ta bërë një punë të tillë. Në s'e bënë, s'e bënë se s'patën ato kushte që pata unë. Të kishin punuar 15 vjet në uzinën e përkthimeve, 8 orë brenda orarit zyrtar dhe 8 orë në shtëpi, 365 ditë të vitit, pa festë ditëlindjesh dhe kryeviti dhe po të kishin sidomos pendën që më kish falur Zana, me siguri që kishin për ta bërë. Këtë punë do ta bëjë më mirë ai që do të vijë. Por mua më kënaq më shumë ajo *Nepërka* që s'e ka bërë tjetri apo ai shkrim i shpejtë përshtypjesh të një udhëtimi që ndrit në jetën time si ata sumbujt e vesës së mëngjesit.

***Një vepër kaq voluminoze - me mijëra faqe të shkruara, një punë mjaft e madhe - mijëra ditë krijimtarie, pa dyshim kërkon edhe një “strategji” afatgjatë të sistemit të punës, duke filluar, bie fjala, nga shfrytëzimi i kohës, prodhimtaria ditore, përdorimi a konsultimi me tekstet, formulimi shkencor i lëndës deri te rregullimi teknik i tyre etj. Si e keni harmonizuar dhe disiplinuar këtë?***

Më flisni për “strategji”, për “disiplinë”, për “shkencë” e më the të thashë, kur unë këto fjalë s'i kam pasur kurrë ndër mend kur shkruaja. Ç'strategjizeza ka bleta kur bën mjalhtë? Mos e di ajo se ç'bën dhe si e bën? Mos e di molla pse bën dhe si e bën mollën? Pjesët e mia më të “bukura” të romanit janë shkruar atëherë kur nëna ime, gojëshuar nga paraliza që i kish rënë, lëshonte ato rënkime që më copëtonin zemrën. A ishte koha për të bërë një gjë të tillë?

*A kemi të drejtë ta quajmë, tashmë, strategjinë tuaj të përkryer përderisa gjenerali i saj kurdoherë ka dalë fitimtar?*

Gjeneral s'kam qenë kurrë por, në qofsha, lus që të mos jem i një ushtrie të vdekur.

*Shqipja në fjalorët tuaj, si në çdo fjalor dygjuhësh, është në një rrafsh me frëngjishten, gjuhë tradicionalisht ndërkombëtare. Fjalorët tuaj frëngjisht-shqip dhe shqip-frëngjisht janë kufijtë e barazisë së shqipes me frëngjishten, apo janë kufijtë e mundshëm kohorë të një intelektualit krijues, edhe pse i palodhshëm?*

Si përgjigje, ju lutem të këndonit parathëniet e fjalorëve të mi, sidomos ata të vitit 1989.

*Obeliskun ose katedralen tuaj frëngjisht-shqip si i kundroni sot pas '60 vjetësh të kërkit, ndërtimit dhe zbukurimit të pandërprerë?*

Fjalët “obelisk” dhe “katedrale” më tmerrojnë. Le të themi më mirë disa pemë në pemishten e varfër të shqipes.

*Ndihmesa juaj është e jashtëzakonshme edhe në fushën e përkthimeve. Prej gjuhëve të mëdha, dmth. prej gjuhëve shumë të pasura dhe të kultivuara: frëngjisht, anglisht, italisht, rusisht keni “kthyer” të flasin shqip autorët botërorë më të njohur: La Fonten, Kornej, Rasin, Volter, Hygo, Balzak, Bodler, Shekspir, Dikens, Gollsuorth, B. Shou, Heminguej, Pushkin, Ljermontov, Esenin, Gorki etj. Shqipja një, përkthyesi një, gjuhët e huaja katër, autorët dhe veprat me dhjetëra. Si i ka përballuar shqipja? Si ia ka dalë mbanë përkthyesi?*

Me punë, me punë të pandërprerë.

*Me cilën vepër të përkthyer keni arritur kulmin? Ju “ka nxjerrë qumështin e nënës nga hunda” ndonjë vepër a ndonjë gjuhë?*

Nuk më gënjen mendja të them, si thoni edhe ju, se kam arritur “kulmin”. Kulmi nuk arrihet kurrë në art. Edhe Homeri i madh ka vende që të vë në gjumë. Lus që këto vende, në shkrimet e mia, të mos jenë aq shpesh gjumëndjellëse sa ta vënë lexuesin në gjumë nga s'do të zgjohej dot kurrë.

“Qumështin e nënës s’ma kanë nxjerrë kurrë nga hunda” ato vepra, sado të vështira, me të cilat jam ndeshur dhe që u kam bërë ballë me dashuri e zell. Qumështin ma kanë nxjerrë ato “të lehtat” që s’i kam dashur. Dhe pa dashuri, asgjë s’durojnë në këtë botë.

### ***A ka parime, kritere shkencore një përkthyes?***

Parime, kritere e më the të thashë ka sa të hajë dreqi, por e mira e të mirave është që ti mos t’i dish dhe të punosh si bleta, pa ditur pse dhe si e bën. Dhe, për këtë, të duhet ajo “thirrje” apo “vokacion”, siç i thonë, dhe duke pasur përherë parasysh fjalët e arta të Virgjilit: “Labor omnia vincit improbus” (Me punë i dilet mbanë çdo gjëje). Këto fjalë, për fatin tonë të zi, bien në vesh të shurdhët. Në i dëgjofshim, s’do vuajmë të zitë e ullirit për mend e kokës.

### ***Nga përkthyesit shqiptarë, cilët çmoni dhe pse?***

S’kam asnjë pëlqim të veçantë. Të gjithë. Sidomos ata që punojnë më shumë. Se kush janë ata, i dinë ata që i lexojnë si duhet. Se ka lexim dhe lexim. Ka lexim me sy e mendje dhe të pesë shqisave bashkë madje dhe me këmbë.

### ***A ka përkthyes shqiptarë me emër, që ju nuk e çmoni? Pse?***

Pas maratonës se këtyre pyetjeve vijmë te kjo e fundit. Kjo pyetje provokuese kërkon të më gicilojë, por tani, nga këmbalkat e mia tetëkatëshe e ca shkallë, asnjë gicilim s’është i zoti të më prekë. Sekretin do ta marr me vete kur të bie në fushën e nderit. Dhe kjo ditë, më duket ende shumë e largët. Do t’jua them në jetëshkrimin tim, që do ta botoj në qindvjetorin e lindjes sime, që është pothuaj te pragu i derës. Deri atëherë, mirupjekshim!

***Mirupafshim në qindvjetorin tuaj të lindjes dhe në botimin e jetëshkrimit tuaj të bukur!***

*Universi Shqiptar i Librit, 1997/2*



## KËNGË

Lart në qiell, pranë e pranë,  
Yjet shih sa bukur rrinë;  
Edhe ne këtu mënjanë  
E sodisim bukurinë.

Hirin Zoti, moj, ta faltë,  
Dhe të zërit melodinë;  
Edhe hëna në mos daltë  
Dritë kemi bukurinë.

1940

Kjo poezi e tij nuk ishte botuar më parë. E kishte shkruar me bukurshkrim.

KAM DASHUR TË SHKRUAJ  
NJË POEZI TË VEÇANTË

*Me poetin Frederik Rreshpja.*

***Ç'është për ju poezia, kaherë dashuruar pas saj?***

Kur isha fëmijë desha të thosha diçka të jashtëzakonshme. Asokohe kështu mendoja, kurse tani përsëri këtë dua, kur qëllon që herë pas here bëhem fëmijë.

***Poezia juaj edhe dikur, kishte pak fakte, hollësi, fjalë karakteristike të përditshmërisë, ndërsa tani, thujse nuk ka fare. Në këtë kuptim i mungon e ashtuquajtura bashkëkohësi. Mungesa e shenjave të bashkëkohësisë është mënyrë e përfimit “të përhershëmërisë”, që mbart në vetvete edhe bashkëkohësinë, apo është diçka tjetër?***

Po, tek unë mungon e ashtuquajtura bashkëkohësi, në qoftë se me fjalën bashkëkohësi kuptohen ato që ju i përfshini te përditshmëria. Unë kaloj nëpër kohë, sepse dua të jem bashkëkohës me të gjithë. Nuk dua të jetoj vetëm me të sotmen, por edhe me të djeshmen, të nesërmen dhe të pasnesërmen.

***Ja, hëna, yjet, erërat, shiu, ylberi, mjegulla etj., përbëjnë metaforën dhe simbolikën kryesore, por “qiellore”, të largët dhe “jotokësore” të afërt, lehtësisht të kapshme. Vallë poeti bashkëbisedon me zotat ku qielli me gjithçka është vetë shpirti njerëzor?***

Nga të tëra këto fjalë që keni vënë re tek unë, mua më tërheq qiell i madh, pasi në të ka diçka mistike e, megjithatë, nuk e harroj kurrë që hapësirat qiellore kanë qenë gjithmonë shenjë e filozofëve, vëllezërve të poetëve. Njerëzit e kanë vendosur me kohë perëndinë mbi tokë, e

kanë vendosur diku në qiell, shpresa jonë në një jetë pas jetës, pas tërë kësaj rruge.

***Pas “shtresës qiellore”, vjen një shtresë metaforike-simbolike e shpirtit njerëzor, si të thuash “shtresa tokësore”, po aq e rëndësishme: dhimbje, vetmi, humbje, durim, vjeshtë, trishtim deri në kufijtë e pikëllimit etj. Këto janë gjendjet dhe ndjenjat poetike zotëruese. Pse një vuajtje kaq e madhe sa përfshin qiell dhe tokë?***

Njeriu sa zbret në tokë ndien humbje, dhimbje, vjeshtë. Vjeshta e jetës. Njeriu është i mbrujtur me dhimbje.

Vetë poezia merr flakë kur shpreh dhimbjen njerëzore. Edhe një peizazh i pikëlluar është pastaj më i afërt. Shumë i privuar është njeriu për ta pasqyruar dhimbjen e tij. Shumë dëshira ka njeriu për të treguar këtë dhimbje, për t’u kuptuar nga të tjerët. Kështu, për këtë shkak, poezia nuk ka ndonjë gjë të jashtëzakonshme në mënyrën se si njeriu tregon jetën e tij fare të zakonshme, është diçka njerëzore, humane, e përbashkët. Sa shumë afrojnë njerëzit me dhimbjet.

Fatkeqësisht jeta është e mbushur me dhimbje.

***Më tej është vdekja, dëshira dhe pamundësia për të vdekur, se “shtëpia e gjetheve” është “kyçur me hënë”. “Erdhi ora të vdes përsëri” është titulli i njërit vëllim (1994), një inversion modern i baladës së ringjalljes, sepse të vdesësh përsëri do të thotë të jesh ringjallur më parë. Poeti është ndonjë Konstandin dhe poezia baladë e ringjalljes?***

Jeta e njeriut mbart në vetvete edhe vdekjen. Çdo ditë, bile çdo moment te ne vdes diçka dhe ringjallet një tjetër. Kështu është jeta. Në qoftë se nuk ka ringjallje, nuk ka jetë. Ne flasim për vdekjen për sa kohë jetojmë, kur nuk jetojmë, s’flasim më. Kjo është vdekja pa filozofi.

***Vëllimi juaj i parë titullohet “Rapsodi shqiptare” (1968), ku nuk mungojnë përbërës të epikës, të cilët më vonë duket se humbën. Por, në thellësi, për ne, jehojnë akordet e lahutës që këndoi rapsodinë, dmth. akorde të epikës. Ky, mos është ndonjë keqkëqim a keqinterpretim i akordeve të poezisë?***

Tipari karakteristik i poezisë sime është epizmi, prandaj titulli i vëllimit tim të parë poetik është *Rapsodi Shqiptare*.

Epikja është një botë që, përgjithësisht, mua më tërheq, pasi si shkodran i përkas një familjeje të vjetër luftarake. Doemos që poezia ime do të ishte e mbushur me rapsodi, me terma që e ofrojnë atë, porë nga një kënd disi lirik. Nga tërë ato figura më tërheqin shumë sharqet...

Më duket se mua, nga i gjithë ai epos i kreshnikëve, më tërheq më shumë Ajkuna. Zot i madh, sa kam dashur një portret të fuqishëm për këtë grua, për këtë nojbe të dhimbjes shqiptare.

***Ju, duke shkruar poezi lirike, në njëfarë mënyre, a u bini edhe akordeve të lahutës së epizmit, sikurse edhe poetë të tjerë lirikë: Migjeni, Kadare, Camaj, Arapi, Podrimja etj.?***

Pra, megjithëse shkruaj poezi lirike, më ka tërhequr mjaft epika.

***Si bashkëjeton epizmi në poezinë moderne lirike?***

Epika me lirikën bashkëjetojnë në një mënyrë të tillë. Njeriu e zgjedh vetë këndin nga e vështron botën. Ky kënd është lirik apo epik. Një ditë me diell apo një ditë me shi e re.

***Fjalori i poezisë suaj nuk është i pasur, madje mund të quhet “i përqendruar” në një varg fjalësh-metafora që merren dhe rimerren, ndërkohë, që, poezia juaj shquhet për shprehshmëri (ekspresivitet). Rolan Barti (Roland Barthes) thotë se shkrimtari nuk njuh veç një art: atë të temës dhe varacioneve. Natyrisht, shprehshmëria qëndron te lidhjet e reja të tyre, te sistemi i funksioneve që krijohen, po të përdornim termin e këtij strukturalisti të njohur. Mund të zbuloni ndonjë nga fshehtësitë e këtij sistemi funksionesh, të fjalëve-metafora më të pëlqyera prej jush?***

Me atë fjalor që kam përdorur, kam dashur të punoj deri në fund. Fjalët t’i intonoj dhe t’i vendos në një mënyrë sa më optimale. Fakti që ky fjalor është disi i ngushtë shpjegohet vetëm me këtë që unë nuk kam pasur kohë të merrem me të gjithë vokabularin poetik të gjuhës sonë. Nuk kam pasur kohë, në kuptimin normal të fjalës, pasi, si dihet, vite e vite, madje tërë koha ime më iku në luftë me diktaturën.

Edhe sot nuk kam kohë. Nuk më del koha, madje ky kapitalizëm i egër që ne po ndërtojmë, me këtë mungesë morali të qeveritarëve tanë, me këtë mungesë të madhe humanizmi e njerëzillëku është kundër artistëve. Ata që do të dalin nga kjo kohë me plagë më të rënda janë artistët. Njerëz të

cilët do ta braktisin artin e tyre, talentin e tyre, për t'u marrë me gjëra të rëndomta të së përditshmes. Është krejt e zakonshme për ne të shohim një aktor të interpretojë shitësin duke shitur, pra, duke jetuar.

***Çdo individualitet e ka një “substrat”, një tërësi filozofish, autorësh, stiles, kombëtarë e botërorë, mbi të cilin zhvillohet, por që, për shkak të integritetit të tij brenda vetvetes, rrallë kapet prej kritikës. Si do të mund të përcaktohej substrati mbi të cilin është zhvilluar poezia juaj?***

Substrati mbi të cilin është zhvilluar poezia ime është bota katolike e Shkodrës së vjetër. Është dashuria për të qenë i kohës në të gjitha udhëtimet e pafundme nëpër botë, është adhurimi që kam pasur për De Radën, këtë gjeni të poezisë. Është dashuria që unë kam pasur për diçka të jashtëzakonshme të perceptuar në fëmijërinë time. Përgjithësisht kam hobi pikturën e kjo mund të vihet re fare lehtë nëpër peizazhet e mia.

***Cili është peizazhi i poezisë shqipe të pasluftës në të gjitha trevat që është krijuar, në perceptimin dhe në vlerësimin tuaj?***

Poezia shqipe pas lufte që skematike, e dobët dhe kishte më se njëfarë hipokrizie poetike. Më vonë, në këtë fushë, pati talente të fuqishme si Kadareja, Agolli, Arapi, pastaj Dhori Qirjazi, Agim Shehu, e më tutje Bilal Xhaferi. Sigurisht, këta kanë marrë diçka nga ai skematizëm i madh, por bie në sy forca e talentit. Ishte një periudhë gjysmëshekullore. Pra, nuk mund të them që nuk u bë asgjë, ashtu si thonë ca njerëz që me një nihilizëm të hatashëm mohojnë gjithçka. Autorët që përmenda, kanë bërë krijime të fuqishme, të cilat përbëjnë në vetvete gjysmën e vlerës së poezisë kombëtare shqipe.

***Vitet e fundit sidomos nga autorët e rinj ka përpjekje, natyrisht, edhe kërkime për modernizëm bashkëkohor në poezi. Në këto përpjekje, mendoni se ka një modernizëm real, të qëndrueshëm apo të pretenduar? Çfarë është moderne, bashkëkohore për ju në poezi?***

Jo, nuk jam i kënaqur nga autorët e rinj. Nuk ka ndonjë përpjekje për të qenë artist i vërtetë, bile kjo nuk ngjet vetëm në poezi, por edhe në fusha të tjera.

P.sh., në pikturë nuk marr vesh se çfarë duan të thonë disa artistë të rinj me atë mungesë kulture, kur nëpër ekspozita vijnë me ca beze të ngjyrosura

me të kuq apo zi, në të cilat thuhet natyrë, lule, portret, e ku, ne nuk shohim në to asgjë tjetër veçse dy pika, tre viza apo ndonjë shkarravinë tjetër.

Ky është një snobizëm dhe një injorancë e pafalshme. Fatkeqësisht, kjo ngjet edhe në poezi. Nuk e kam fjalën te braktisja e rimave, ritmeve, jo, por asgjë s'mund të ndërtohet pa u mbështetur në traditën. Të gjitha ato vlera që ka krijuar njerëzimi në poezi nuk mund të hidhen poshtë, sidomos kur kemi të bëjmë me autoritete të tilla të jashtëzakonshme që nga Homeri, Arqiloku, Dante, Gëte, Esenini, Jits e Ezra Paundi dhe dhjetëra gjeni të kësaj fushe.

Shumë autorë të rinj shkruajnë gjëra fare banale dhe të zakonshme. Në këtë gjendje që po jeton Shqipëria ne po shohim dështime edhe në politikë, jurisprudencë, ekonomi. Mendoj se është një fatkeqësi që duhet të kapërcehet.

### ***Diçka për veten tuaj?***

Hobi im ka qenë filozofia, mjekësia, kimia e përmby të gjitha piktura. Kam lexuar shumë, në disa gjuhë, më vonë më kanë përkthyer në disa gjuhë, por piktura më ka pëlqyer vazhdimisht. Në letërsi s'kam pasur ambicie. Fakti që kam qenë i përkëdheluri i kritikës, shpjegohet me atë që nga natyra jam shumë punëtor dhe dua të shpie deri në fund çdo gjë, qoftë edhe ndonjë vjershë të vogël. Nuk kam ndonjë krijim të preferuar. Po të kisha kohë, do të punoja më shumë për të përsosur artin tim poetik.

Nga të tëra sa thashë, del se unë ende nuk e kam plotësuar rrethin tim poetik, fjalorin, stilin. Deri tani mbase njihet vargu im, por ajo që kam dashur të bëj ka qenë një vorbull e madhe, një opus me dhjetëra libra nga m'u desh të nxirrja atë që desha.

Zoti i madh e di, mbase kam kohë, kam kohë që të heq dorë nga kjo veprimtari e detyruar prej afaristi e, atëherë, do të mund të merrem seriozisht me poezinë. Megjithatë, e përsëris se nuk kam dashur të zë ndonjë vend të veçantë në poezi, por kam dashur të bëj një poezi të veçantë. A ia kam arritur?!... Këtë ta thoni ju dhe të tjerët.

***Natyrisht. Biseda jonë është, pikërisht, për vlerat dhe veçoritë e poezisë suaj.***

***Ju faleminderit!***

*Universi Shqiptar i Librit, 1997/3*

## GJUHA E NJËSUAR ËSHTË THEMELI MBI TË CILIN MUND TË NDËRTOHET PALLATI I INTEGRIMIT KULTUROR

*Me shkrimtarin dhe akademikun Rexhep Qosja.*

### 1. INTEGRIMI I VËRTETË KULTUROR ËSHTË KUR INTEGRIMI TË INSTITUCIONALIZOHET

***Me rënien e murit ideologjik që ndante shqiptarët, u besua se erdhi “çasti ynë i mbramë dhe fatlum”, prandaj u shtrua me të madhe çështja e integrimit kulturor për të mbërritur më vonë tek integrimi ekonomik, politik e shtetëror. A ishte vërtet “çasti ynë fatlum”? Ishin të përgatitur shqiptarët për këtë çast?***

Përmbysja e komunizmit, në një rën të anë, kurse shpërbërja e perandorive të fundit në kontinentin evropian - e Bashkimit Sovjetik, Çekosllovakisë dhe e Jugosllavisë, në anën tjetër, hapi mundësi historike për krijimin e shteteve të reja kombëtare në hapësirat etnike që sundoheshin prej tyre. Dhe, u krijuan një sërë shtetesh të reja kombëtare. Vetëm nga ish-Jugosllavia deri tani u krijuan pesë shtete të reja. Kjo pranverë e popujve të mbisunduar, s'ka sesi të mos pritej si pranverë e shqiptarëve të paçliruar dhe të shqiptarëve në Shqipërinë shtetërore. Kishim dy shpresa: shpresën e çlirimit prej diktaturës komuniste dhe shpresën e çlirimit prej sovranitetit sllav. U çliruam prej diktaturës komuniste sado jo edhe prej autokracisë pas komuniste - Shqipëri, por nuk u çliruam prej sovranitetit sllav në Jugosllavi e Maqedoni! Në të vërtetë, shqiptarët në Shqipëri, në vend që të futeshin në demokraci, u futën në një kaos politik, ekonomik e moral, si pasojë e luftës militante ndërpartiake! Forcat politike shqiptare në Kosovë, ndërkaq, në vend që të organizoheshin në lëvizje kombëtare, që do ta lëvizte popullin përmes protestave, grevave, demonstratave, e trajtave të tjera të mosbindjes qytetare, vetë u mbyllën në shtëpi e zyra, kurse rininë e zhvendosën në botën e huaj!

Në pranverën e popujve, që solli përmbysja e komunizmit dhe shpërbërja e perandorive të sipërtheksuara totalitare, shqiptarët nuk vepruan si tërësi, domethënë si komb modern. Përkundrazi, në jetën e tyre politike u shfaqën faktorë destruktivë, që shkaktuan humbjen e kotë të energjisë së popullit dhe humbje të kohës historike! Në këto çaste të mëdha historike, sjelljet, veprimet, dhe mjetet tona ishin sjellje, veprime dhe mjete historikisht të vogla, johistorike. Tani mund të thuhet: ishim të papërgatitur! Është humbur shumë kohë, por, megjithatë nuk është humbur krejt koha! Pranvera e popujve të paçliruar, vërtet, është bërë vjeshtë, por ende nuk është bërë dimër.

***Pas shtatë vjetësh doemos do të pyesim veten: “Çfarë është bërë për integrimin kulturor? Çfarë mund të kryhej edhe më, pavarësisht nga rrethanat tejet të vështira, sidomos për shqiptarët nën Serbi, Maqedoni dhe Mal të Zi?”.***

Pavarësisht prej disa rrethanave kufizuese, ka mundur të bëhet më tepër për integrimin kulturor të shqiptarëve në të dyja anët e kufijve të dhunshëm që i ndajnë! Ne nuk mund të flasim sot për farë integrimi të vërtetë kulturor. Pse do të më botohet mua kjo bisedë në revistën *Universi Shqiptar i Librit* në Tiranë; pse janë botuar ca përmbledhje vjershash e romane të shqiptarëve nga Shqipëria në Prishtinë a në Shkup; pse këngëtarë nga Shqipëria shtetërore këndojnë në Prishtinë, në Prizren a në Tetovë, kurse këngëtarë nga Kosova e Maqedonia këndojnë në Shqipërinë shtetërore - të gjitha këto nuk janë të mjafta që të flasim për integrimin kulturor të shqiptarëve. Jo. Për integrimin kulturor kombëtar do të mund të flasim atëherë kur integrimi të institucionalizohet. Integrimet kulturore kombëtare, gjithmonë e gjithkund, janë pararendëse të integrimëve ekonomike, politike dhe shtetërore. E ne, sot për sot, sikur s’jemi për këtë plotësisht të vetëdijshëm!

***Universitetet e Tiranës dhe të Prishtinës, sikurse edhe Akademitë e Shkencave, institucionet e programeve dhe të teksteve shkollore etj., hodhën ide, nisën disa projekte, por nuk arritën në një strategji të integrimit kulturor. Pra, u krye diçka e pjesshme në vend të një pune të madhe sistematike afatgjatë. Përse ndodh kështu me shqiptarët edhe në ditët tona, kur janë të ndërgjegjshëm për gabimet në histori, siç janë të ndërgjegjshëm edhe për dobësi të tilla?***



Ne bëjmë shpesh improvizime! Ne i nisim punët dhe shpesh i lëmë në gjysmë të rrugës. Gjysma është një shenjë kobi në historinë tonë, sepse shumëçka në jetën tonë ka mbetur përgjysmë! Madje, edhe shtetin e kemi bërë prej gjysmës së tokave etnike dhe prej gjysmës së popullit! Nismat pas të cilave nuk qëndron organizata që i thonë shtet, shpesh përfundojnë si improvizime, shpesh mbesin në gjysmë të rrugës. E derisa pas qëllimit të integritimit kulturor të shqiptarëve të mos vihet vendosmërisht shteti shqiptar, Shqipëria, ky integrim do të mbesë i painstitucionalizuar dhe pa shumë përmbajtje.

***Veç rrethanave, që kanë qenë pengesa kryesore në integrimin kulturor, mos kanë qenë të “vështirë” edhe një pjesë e misionarëve tanë kulturorë, dmth., ata që nuk e kanë kryer atë që mund të kryenin e si duhet ta kryenin?***

Nuk e di se kujt krejt u janë besuar disa punë të integritimit kulturor, por e di se në grupet që kanë bërë programet dhe tekstet shkollore dhe në grupin që ka drejtuar Seminarin e Gjuhës, të Letërsisë dhe të Kulturës Shqiptare janë gjetur njerëz të zgjedhur me kritere partiake e joprofesionale! Punë të mëdha ngjet kështu të çohen poshtë për shkak të interesave të grupimeve të vogla.

## **2. ATA QË KËRKOJNË DY GJUHË LETRARE BËJNË BETEJËN PËR DY KULTURA SHQIPTARE**

***Po, a mund të ketë strategji të integritimit kulturor kombëtar pa gjuhën e përbashkët letrare, së paku, dhe, fillimisht, pa konsensusin e gjuhës së njësuar letrare?***

Pa gjuhën e përbashkët letrare nuk mund të flitet për integrimin kulturor të shqiptarëve. Gjuha e njësuar letrare është themeli mbi të cilin mund të ndërtohet pallati i integritimit kulturor shqiptar. Të kesh pajtim për gjuhën e njësuar letrare, domethënë të kesh pajtim për integrimin. Të mos kesh pajtim për gjuhën e njësuar letrare, çdo bisedë për integrimin kulturor është mashtrim, sepse mospajtimi me gjuhën e njësuar letrare pashmangshëm sjell mospajtim me integrimin kulturor kombëtar. Ata që kërkojnë dy gjuhë letrare, pavarësisht si e “arsyetojnë” kërkesën e tyre, ata vetëdijshtëm a jo, bëjnë betejë për dy kultura shqiptare, në të vërtetë për kombe të ndara

shqiptare, bëjnë betejën për shqiptarët që do të jenë në marrëdhënie të ndërsjella, siç janë në marrëdhënie të ndërsjella kulturore, politike dhe shtetërore austriakët dhe gjermanët!

***Cilat ndjenja kombëtare, cilat parime themelore shkencore janë shkelur në krijimin e gjuhës së njësuar letrare që është kundërshtuar prej disave me forcë, madje edhe me mlllef?***

Rruga e krijimit të gjuhës së njësuar letrare nuk dallon prej rrugëve të krijimit të gjuhëve letrare të disa kombeve të tjera europiane. Nuk dallon, fjala vjen, prej rrugës së krijimit të gjuhës letrare franceze, apo italiane, apo polake, apo gjermane. Te të gjithë këta popuj një dialekt është marrë për bazë të gjuhës letrare. Në rastet më të shpeshta këtë zgjedhje e bëjnë klasa politike dhe intelektuale, kurse në Francë, fjala vjen, këtë zgjedhje e bëri Monarku. Fakti pse Monarku ua ka bërë gjuhën letrare kurrë s'është bërë arsye për francezët ta kundërshtojnë gjuhën e integritimit të tyre kombëtar. Përkundrazi: e çmojnë dhe e duan më tepër se asgjë tjetër në qiellin e Francës.

Ti më pyet se cilat parime themelore shkencore janë shkelur në krijimin e gjuhës së njësuar? Gjuhëtarët tanë, që kanë lindur në një mjedis ku flitet toskërishtja dhe në një mjedis ku flitet gegërishtja, i kanë treguar gjerë e gjatë argumentet historike gjuhësore dhe historike kulturore që e arsyetojnë marrjen e toskërishtes për bazë të gjuhës së njësuar letrare. Sado nuk jam gjuhëtar, mendja ma thotë se gegërishtja, si dialekt i asaj pjese të popullit shqiptar që jeton në kushte gjeografike që kanë shkaktuar veçimin e tij historik, është dialekt pak a shumë i konservuar, të cilit, prandaj i mungon gjallëria historike e toskërishtes. Kjo është arsye e rëndësishme, që e shquan përparësinë e toskërishtes me rastin e zgjedhjes për bazë të gjuhës së njësuar letrare.

***Çfarë meriton të rishikohet e të përmirësohet?***

Gjuha letrare është sistem dinamik e jo statik. Punët themelore në gjuhën letrare shqipe janë bërë, kurse tani presin të bëhen punë rreth hollësive. Ka çështje gramatikore e drejtshkrimore që kanë mbetur të pazgjidhura, prandaj duhet të zgjidhen. Duhet të rishikohen edhe fjalët e huaja, që janë gjithnjë e më të shpeshta në gjuhën e sotme letrare!

Gjuhëtarët thonë se drejtshkrimi, si përmbledhje rregullash, mund të rrojë vetëm disa dhjetëra vjet. 25 vjet pas miratimit, sigurisht, mund të rishikohen disa trajta të drejtshkrimit të sotëm të shqipes.